



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 28 qershor 2021, në mbledhjen e LI-të (pesëdhjetë e një) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (Lista e nënshkrimeve). Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive (*DA, DKRS, DKA, DBF, DPKGJ, DI, DPUMM, DSHPMSh, DBPZHR, DSHMS*) të Komunës së Podujevës, si dhe një numër i zyrtarëve komunal.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe iu dëshiruar punë të mbarë në këtë seancë. Shtoi, kuorumi për punë dhe vendimmarrje ekziston andaj mund të vazhdojmë me punë në këtë seancë, materialet gjithashtu i keni marrë me kohë përshirë edhe rendin e ditës dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

Rendi i ditës

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, para se të fillohet me rendin e ditës unë e kam një propozim, propozim i cili rrjedh nga një numër i madh i qytetarëve anekënd Komunës së Podujevës. Ne tani veç jemi në dijeni për Rregulloren e vitit 2020 me të cilën rregullohet orari i punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, sipas të cilës faktikisht qytetarëve tanë po u cenohet e drejta e furnizimit të lirshëm gjatë ditës së diel, prandaj duke pasur parasysh kërkesën e qytetarëve dhe duke pasur parasysh se një numër i madh i bizneseve kanë gatishmërinë që dita e diel të jetë ditë pune dhe sidomos në këtë periudhë kohore kur pritet që të vijë një numër i madh i bashkatdhetarëve tanë, unë propozoj që për Rregulloren në fjalë, konkretisht aty ku thuhet / shkruhet që dita e diel është ditë pushimi, në njëfarë forme të marrim një vendim sot si Kuvend dhe të paktën t'i pezullojmë përkohësisht dispozitat e Rregullores të cilat e ndalojnë punën e bizneseve ditën e diele dhe sigurisht t'i jepet detyrë Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE që në afatin sa më të shpejtë të mundshëm, përafërsisht deri nga fundi i muajit shtator 2021 ta përgatis draft Rregulloren e re me të cilën do i rregullojmë të gjitha pikat të cilat mendojmë që aktualisht janë në defekt sipas Rregullores në fuqi dhe e cila në njëfarë forme i ka paralizuar qytetarët e Komunës së Podujevës. Pa dashur ta zgjasë shumë, mendoj që është e rëndësishme sidomos në këtë fazë kohore ku ju e shihni që Liqeni i Batllavës dhe bizneset të cilat ndodhen në atë zonë janë paralizuar totalisht, qytetarë të ndryshëm po marrin produkte të ndryshme me vete në vend që bizneset tona të fitojnë gjatë kësaj periudhe kohore në atë zonë, por krejt çka jemi duke fituar ne si Komunë është një sasi e madhe e mbeturinave të cilat mbesin në atë zonë, ndërsa bizneset tjera jashtë komunës tonë përfitojnë nga kjo çështje.

Po ashtu tani jemi në periudhën kur një numër i madh i bashkatdhetarëve vijnë për pushime në Kosovë dhe sigurisht që nevojat dhe kërkesat e tyre janë që këto biznese ta zhvillojnë aktivitetin e tyre edhe ditëve të diela, të paktën për këtë periudhë kohore, prandaj kam besimin e plotë që do ta mbështetni këtë propozim për pezullimin e atyre dispozitave/pikave të rregullores ku thuhet se dita e diele është ditë pushimi, ndërsa pjesa tjetër e orareve të mbetet në fuqi deri në Rregulloren e re.

znj.Mimoza Stublla - Abdullahu, theksoi, vetëm dëshiroj të di që derisa ne jemi të pajtimit me u hap bizneset ditëve të diela, mirëpo a e keni marr parasysh pjesën e punëtorëve sepse të gjitha bizneset nëse punojmë edhe të dielave punëtorët e kanë vetëm një herë në javë pushim, vetëm një ditë në dy javë pushim, për çka mua personalisht më janë ankuar shumë punëtorë që në dy javë kanë vetëm një ditë pushim. A mundet me u marr me këtë problematikë Inspektorati i punës, të paktën edhe nëse punojnë ditëve të diela dhe nuk e kanë asnjë ditë pushim, të bëhet me pagesë ajo ditë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, përgjigje parafolëses, theksoi, e respektuara asambleiste, keni të drejtë plotësisht, por unë mendoj që kjo çështje është e rregulluar mirë me Ligjin e punës, prandaj duhet kërkuar nga Inspektorati i punës por edhe nga Inspeksioni komunal që kohë pas kohe ta bëjnë verifikimin e atyre kompanive të cilat nuk respektojnë kontratat, për arsye se punëtorët e kanë të rregulluar këtë çështje me kontratë pune.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sa i përket kësaj rregulloreje duhet të jesh subjektiv zotëri Kryetar i Komunës Shpejtim Bulliqi, e them këtë sepse ky është Ekzekutivi juaj, respektivisht drejtori z.Pajtim Balaj dy herë e ka sjell në Kuvend draft rregulloren në fjalë, pse nuk ka kaluar të gjithë ne e dimë.

Tani konkluzat që i nxjerrim ne, jemi jashtëzakonisht të arsyeshëm në atë që e kemi thënë, andaj nuk qëndron ajo se në çoftë se dëmtohet, ti jepet një lloj mundësie opozitës të pajtohet, sepse ajo ka qenë punë e drejtorit tuaj i cili me apo pa vetëdije nuk e ka kaluar dhe për këtë jemi në dijeni të gjithë këtu, dhe tani të propozohet kjo masë pezulluese siç u propozua pa e studiuar mirë materien, gjykoj që do të ketë telashe në të ardhmen. Po ashtu të gjithë jemi në dijeni se në seancën e parafundit kur është sjellë propozim për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores në fjalë, keni pasur një peticion edhe prej subjekteve të ndryshme të cilat me vetëdije thonë që nuk jemi të interesuar të punojmë ditëve të diela, por sido që të jetë gjykoj që dy herë ka dështuar miratimi i draftit të rregullores për tu plotësuar dhe ndryshuar dhe kjo është dështim i qeverisë tuaj në këtë rast, nuk është dështim i Kuvendit. Ka mundur edhe drejtori i DPZHE z.Pajtim Balaj që realisht nuk është sot këtu, ta studioj dhe rregulloj mirë materien, mirëpo ai, ju e dini shumë mirë, ai ka dashur që në njëfarë forme të e nxisë opinionin, të ndërtoj disa të drejta që as në ligj nuk i ka pasur, siç është ajo me m² për disa dyqane ushqimore, sido që të jetë pse ka dështuar ky lloj ndryshimi është punë e Ekzekutivit tuaj nuk është punë e Kuvendit dhe tani përderisa nuk ke mundur ta kalosh përmes procedurave të rregullta po kërkon prej Kuvendit që të vëhet masë pezulluese, respektivisht suspendim të kësaj rregulloreje për shkak të arsyetimeve që i ceke Kryetar.

Unë në cilësinë shefit të Grupit të këshilltarëve të LDK-së kam qenë i interesuar për të bërë një zgjidhje realisht prej drejtorit z.Pajtim Balaj për të cilin mendoj se nuk është etike ta përmendim kaq shpesh pasi nuk është prezent në këtë sallë, pra ka pasur alternativa dhe mundësi të bëhet zgjidhje edhe me dyqanet ushqimore, ka mund ta përdor rrotacionin sikurse që e kanë barnatoret në qytet karshi lagjeve, por nuk ka dashur drejtori të ketë konsultime me neve por ka shkuar në mënyrë individuale e ka mëndur që mund ta kaloj, mirëpo dy herë nuk ka mundur ta kaloj në Kuvend, kështu që rreth kësaj pike gjykoj se është prej Ekzekutivit që ju e drejtoni.

Tani kërkesa juaj Kryetar që e bërë mendoj se është normale dhe legjitime, mirëpo duhet të jeni edhe ju real karshi qytetarëve sepse kjo çështje dy herë është tentuar përmes Ekzekutivi të juaj dhe nuk ka kaluar, pasojat nesër për këtë pikë i marrin normal Ekzekutivi që ju e drejtoni.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ju z.Hasan Ajeti keni të drejtë për disa prej këtyre çka i potencuat, unë vetëm sa për opinion publik dhe qytetarët, kjo rregullore është hyrë në fuqi me 31 janar 2020 kur ne nuk kemi qenë në Ekzekutiv dhe nuk është që e kemi prodhuar ne këtë rregullore sepse e kemi gjetur këtë rregullore dhe pastaj Ekzekutivi ynë dy herë ka bërë përpjekje për ta tejkaluar këtë pengese dhe këtë problem të qytetarëve, dhe kjo që sot unë po e propozoj është hera e tretë që po kërkojmë si Ekzekutiv të gjejmë mirëkuptim bashkërisht të gjithë që jemi këtu të pezullojmë pikat e rregullores ku thuhet se dita e diel është ditë jo pune, pra jo e gjithë rregullorja të pezullohet sepse pastaj do krijohet çrregullim në kuptim të bizneseve dhe aktiviteteve të tyre.

Pra kërkojmë mirëkuptimin e juaj që të pezullojmë nenet e rregullores sipas të cilëve dita e diel nuk është ditë pune, besoj që në këtë çështje kemi mirëkuptim dhe se edhe kjo është çështje e interesit qytetarëve por edhe e interesit të përgjithshëm, prandaj këtë fazë ta tejkalojmë deri sa nuk arrijmë ta bëjmë një harmonizim të përbashkët dhe një rregullore e cila do të përkrahej nga të gjithë ne.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, atëherë nëse ekziston mundësia e pezullimit ashtu siç e propozoj Kryetari z.Shpejtim Bulliqi, Grupi i LVV-së e përkrah.

z.Hasan Ajeti, theksoi, është e vërtetë zotëri Kryetar që në janar 2020 është hyrë në fuqi rregullorja në fjalë e cila është bërë në kohën e qeverisjes së LDK-së, por po ashtu është e vërtetë që në atë kohë kanë qenë rrethana tjera, së pari nuk ka qenë pandemia që ka ardhur me shumë të panjohura për çka të gjithë jemi në dijeni. Pastaj askush prej Grupeve të subjekteve politike në këtë Kuvend nuk ka qenë kundër ndryshim plotësimit të kësaj rregulloreje sepse rrethanat në vazhdimësi ta imponojnë për ta bërë këtë, mirëpo ajo që është me rëndësi dhe që duhet thënë është se ka qenë dështim i Ekzekutivit për ta harmonizuar plotësim-ndryshimet e rregullores, kjo është publike dhe dihet që ne të gjitha Grupet e këshilltarëve kemi qenë për, është temë tjetër dhe gjithsecili prej nesh mund t'i jep artikulum ose konotacion kësaj teme, mirëpo të gjithë e dimë që z.Pajtim Balaj këtë materie nuk e ka studiuar aq, sa që të ka prodhuar telashe edhe ty si Kryetar Komune edhe si Ekzekutiv.

Mund t'i merrni propozimet për rregulloren në fjalë nga seanca e parafundit, prandaj kjo është përgjegjësi e Ekzekutivit dhe në këtë çështje keni treguar pa atësi për ta zgjidhur këtë plotësim-ndryshim të rregullores së cekur dhe tani është shumë normale që e kërkon këtë mbështetje prej Kuvendit edhe pse dorën në zemër në pyetjen që ta bëri këshilltarja nga ana e PDK-së, ne jemi në dijeni të gjithë shumë mirë se sa është kapaciteti, jo pse ju jeni në pushtet por edhe të tjerët me qenë në pushtet, të përcillen të drejtat dhe obligimet që burojnë prej marrëdhënies së punës për punëtorët që punojnë në sektorin privat, sepse ne e dimë mirë që ajo është kompetencë edhe e institucioneve të nivelit qendror dhe jo kompetencë prej nivelit lokal. Sido që të jetë për mos t'i ikë të gjithë materies, është mirë të punohet edhe ditëve të diela. 2 herë është sjell kjo propozim rregullore në Kuvend dhe ka dështuar për shkak të Ekzekutivit tuaj.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kërkesa e Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi ishte që kjo pikë të futet në rend dite dhe ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së do ta përkrahim që të futet në rend dite dhe pastaj kur të vije radha për shqyrtim do të diskutojmë dhe do të japim qëndrimin a jemi për apo kundër një propozimi vendimi të tillë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, vetëm shkurt po ndërlidhem me atë që e tha z.Hasan Ajeti, ne e dimë të gjithë që dy herë ka ardhur kjo rregullore në Kuvend, dy herë nuk është përkrahur, herën e parë është ardhur që të marrin ide dhe mendime prej gjitha Grupeve të këshilltarëve, pjesë e këtyre ideve ka qenë edhe LDK-ja, mirëpo as herën e dytë nuk është përkrahur, dhe tani ideja e Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi është ide shumë e mirë. Zotëri Hasan Ajeti unë tani nuk po e kuptoj, është ajo thënia popullore që e përdoret “as nuk ngrehet as nuk grahët”.

z.Hasan Ajeti, theksoi, z.Ragip Fetahu po e shoh që po ke dëshirë me u merr me këtë punë, por unë po të kuptoi sepse i ke zgjedhjet afër dhe duhet me u rëndit mirë, po këtë temë zotëri e keni sjell ju

vet që jeni në pushtet, ti je në pushtet dhe ti vet nuk e ke votuar në seancën kur ka qenë në redn të ditës dhe këtë e dim të gjithë sepse këtu kemi qenë, pra ju vet e keni sjell dhe vet ke dal dhe ke thënë duhet të plotësohet-ndryshohet propozimi përkatëse, në çoftë se nuk ke harruar dhe e ke memorien mirë herën e parë ka ndodhë kjo. Tani kjo është përgjegjësi e juaja dhe pranoje që ke dështuar si Ekzekutiv ashtu siç keni dështuar në shumë projekte tjera, prandaj nuk ke çka merresh ti me mua si Hasan sepse unë nuk e kam sjell këtë rregullore në Kuvend, pastaj nuk e ke drejtorin e drejtorisë përkatëse këtu fare prezent ngase shumë mirë e dini ju përse nuk vije këtu ai dhe se si i keni raportet me të, shumë mirë i dini, kështu që në moment që tenton diçka tjetër dije që ke humb sepse ti e ke pushtetin, ti i sjell temat, nëse i ke votat kalon nëse nuk i ke atëherë e kërkon ndihmën nga opozita, dil dhe thuaje po na duhet për ta miratuar sepse nuk kemi mund dhe nuk kemi ditur të menaxhojmë mirë këtë çështje atëherë edhe e ke përkrahjen, kaq.

z.Haki Rudari, theksoi, duke e parë që është një gjendje vërtetë e rëndë në përgjithësi, duke parë që qëllimi i Kryetarit ishte që me iu dedikua të gjithëve, unë në parim e përkrahi propozimin e Kryetarit. Kërkesa e Grupit të këshilltarëve të PDK-së ishte për hedhjen në votim fillimisht, të futet në rend dite e pastaj të debatohet kur të vije çështja e rendi të ditës, tani është që kërkesa të hudhet në votim dhe të kalojmë më tutje.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, mora fjalën vetëm për t'i jap dy sqarime, e para nuk po më pëlqen ideja që e kanë sjell këta ose e kanë sjell ata, e kam thënë që nga fillimi kur ka ardhur për plotësim ndryshim kjo rregullore, që kjo rregullore është bërë në kohën e qeverisjes së LDK-së por është përkrahur me unanimitet të plotë nga ky Kuvend, pastaj për këto dy rastet e tjera jemi dëshmitarë dhe madje jemi transmetuar direkt dhe tek qytetarët të cilët kanë mundur ta shohin se si rrjedh ky proces. Tani unë sot mendoj që nuk është shumë e rëndësishme se a do ta futim në rend dite dhe a do të arrijmë ta kalojmë apo jo, mirë do të ishte që për çdo vendim të ketë konsensus të përgjithshëm por e dimë që kemi pasur praktika në të kaluarën që për shkak të pandemisë Covid-19 por edhe për shkak të situatave të caktuara kur e ka kërkuar nevoja, Kryetari nëse e ka vullnetin mund ta bëjë vet pezullimin, e ka këtë të drejtë por si duket po ka më shumë dëshirë të hidhet faji se jo këta ishin për këta ishin kundër. Prandaj unë mendoj që nuk duhet të bëjmë shumë as retorika politike as këta as ata, ne duhet ta kemi një qëllim që ta bëjmë më të mirën për qytetarët e Podujevës, nëse mendoni se kjo është më e mira atëherë besoj që nuk ka asnjë pengesë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nuk është qëllimi të bëjmë politikë me këtë çështje, nuk jam duke bërë politikë as unë dhe Kryetari nuk e ka mundësinë ta pezulloj sepse është vendim ose akt i Kuvendit të Komunës dhe ju e dini shumë mirë që vendimet dhe rregulloret e Kuvendit nuk i pezullon Kryetari i Komunës por Kuvendi, pra nuk është i nivelit tim si organ ky vendim sepse po të kishte qenë i tillë unë garantoj se qysh moti nuk do ta kishim në fuqi këtë rregullore sepse ka shkaktuar dhe është duke shkaktuar telashe, por nëse e keni vullnetin të arrihet një konsensus mund ta bëni. Unë nuk jam duke e akuzuar askënd, situata ka ardhur deri këtu ku ka ardhur, dihet ku janë fillet, dihet ku është fundi i kësaj rregullore, prandaj nëse e keni deponimin ta përkrahni urdhëroni, që nuk e keni disponimin, ne pa vota këtë nuk mund ta pezullojmë. Pra edhe njëherë po e potencoj se nuk bëhet fjalë për pezullimin e rregullores në tërësi, por vetëm nenet dhe pikat që ndalojnë lejimin e punës ditëve të diela, por jo rregullorja në tërësi sepse rregullorja nuk bënë të pezullohet ngase pastaj krijohet kaos me bizneset, madje me këtë Rregullore rregullohen edhe disa çështje të bizneseve siç janë kujdestaritë të cilat nuk kemi të drejtë t'i pezullojmë sepse na krijohet telashe në teren pastaj por pezullohen vetëm dispozitat të cilat ndalojnë punën ditëve të diela.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, vetëm më duhet ta sqaroj, unë e kuptoj plotësisht që Rregullorja as nuk mund të pezullohet as nuk mund të ndryshohet nga ana e Kryetarit pa miratimin e këtij Kuvendit që e ka nxjerr Rregulloren në fjalë, por e thashë dhe i qëndroj fjalës sime se ka pasur situata në të cilat edhe në kohën e pandemisë kur ka qenë në qeverisje LDK-ja por edhe pas asaj periudhe në kohën kur ka qenë një numër më i madh i mërgimtarëve, pikërisht neni të cilin po e kërkon sot pra me vendim të Drejtorisë përkatëse është pezulluar vetëm dita e diele si ditë pune.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet rreth këtij propozimi përfunduan meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, andaj e vë në votim propozimin e Kryetarit të Komunës që propozimi në fjalë të hyjë në rend ditë, dhe atë si pikë e parë e rendit të ditës.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, 17 vota të PËRMBAJTURA, miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për përfshirje si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje, dhe atë;

- ***Propozim për pezullimin e dispozitave të Rregullores për orarin e punës së bizneseve, konkretisht lejimin që dita e diel të jetë ditë pune për bizneset.***

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim rendin e ditës në tërësi sipas thirrjes dhe pikës shtesë që hyri paraprakisht.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë e cila hynë në pikën 1 të rendit të ditës, ndërsa pikat tjera renditen sipas radhës

1. **Propozimi për pezullimin e zbatimit të dispozitave të Rregullores për orarin e punës së bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës, përkatësisht lejimi që dita e diele të jetë ditë pune për subjektet afariste**

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, të respektojmë anëtar të Kuvendit, ashtu siç e paraqita para pak minutash, unë para vetës këtu e kam Rregulloren për orari e punës për bizneset që operojnë në Komunën e Podujevës dhe termi dita e diele dhe festat zyrtare nuk punohet ta zëmë e kemi në shumë nene, vetëm po i potencoj disa prej tyre, neni 5 pika 4.4 pastaj neni 7 pika 2, neni 9 pika 1.3 dhe shumë nene dhe pika tjera, dita e diele dhe festat zyrtare nuk punojnë përjashtimisht rastet e dërgesave të ahengjeve dhe rasteve mortore, do të thotë po mendoj që vetëm në këtë pasues ku thuhet që dita e diele nuk punohet, nenet përkatëse t'i pezullojmë/suspendojmë përkohësisht deri në hartimin dhe plotësimin e një rregulloreje të re me kompromis të të gjithëve dhe ta zgjedhim këtë problem. Besoj që pjesët tjera dhe nenet tjera të kësaj rregulloreje siç është çështja e kujdestarive dhe gjërave të ngjashme tjera për barnatoret dhe të tjera që lidhen me bizneset, është mirë të ruhen me po të njëjtën formë në mënyrë që të mos na krijohet problem pastaj sepse mund të na dalin telashe pastaj. Do të thotë esencialisht poenta dhe qëllimi është që ditëve të diela të lejohet puna, përkatësisht të pezullohen dispozitat e rregullores që ndalojnë punën ditëve të diela.

z.Hasan Ajeti, theksoi, askush në këtë Kuvend nuk ka qenë kundër plotësim-ndryshimit të kësaj Rregulloreje përveç që dihet se dy herët e fundit ka ardhur si propozim nga DPZHE dhe nuk ka kaluar, arsyeja pse nuk ka kaluar ka qenë mos koordinimi që po e përmend sot pa rreshtur Kryetari z.Shpejtim Bulliqi e që dorën në zemër i ka munguar si raport i koordinimit por është punë e tyre. LDK është dhe ka qenë në përkrahje të bizneseve, si ato të vogla ashtu, të mesme dhe të mëdha, tani mekanizmat tjerë që e mbikëqyrin këtë proces është temë tjetër, unë thashë edhe më parë gjatë

diskutimit se në momentin kur pezullohen dispozitat në fjalë të gjitha bizneset në Komunën e Podujevës funksionojnë dhe punojnë pa asnjë dallim dhe asnjë biznes nuk e ka më këtë masë.

Shumë i nderuari Kryetar zotëri Bulliqi, atë që e kërkuat më herët për shkak të aspektit politik, e vërteta është ajo që Drejtori juaj (fjala është për drejtorin e DPZHE) dy herë ka dështuar për shkak të atij mos bashkëpunimit që e cekët ju pak më herët, e që fatkeqësisht ka munguar edhe me bizneset. Edhe në të ardhmen kur të vije propozim ndryshimi i Rregullores në fjalë duhet të jemi shumë konciz edhe në aspektin e asaj rreth vijave të holla sepse të gjithë ne që jetojmë këtu jemi në dijeni dhe i kuptojmë kurse ata që jetojnë në Prishtinë munden ta kuptojnë më ndryshe sepse nuk janë këtu. Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së asnjëherë nuk jemi kundër interesave të bizneseve por jemi gjithmonë në harmoni dhe në pajtim me aktet që janë në fuqi, dhe duke e ditur edhe rolin e opozitës, tani pushteti jeni ju dhe ju duhet t'ju shkonin këtyre proceseve deri në fund, ndërsa pas tetorit është çështja tjetër.

z.Fatmir Rudari, theksoi, ne fillimisht nuk bëmë debat sepse fillimisht u fut si pikë e rendit të ditës çështja në fjalë, është e vërtetë që kjo pikë ka ardhur dy herë në Kuvend dhe nuk ka kaluar, jo për fajin ton por për arsye se nuk ka ardhur ashtu siç është dashur, do të thotë të gjithë këshilltarët kanë qenë kundër që pika në fjalë të kalojë ashtu siç ka ardhur prej drejtorit të DPZHE-së. Është e vërtetë që si qytet por edhe nëpër fshatra jemi bllokuar të gjithë dhe lejimi i punës ditëve të diela po na mungon të gjithëve, mirëpo Kryetari i Komunës në një dëgjim me qytetarët tha se po më bllokun opozita për çka e them se nuk është e vërtetë sepse kemi pasur kërkesë qysh në seancën e parë kur është sjellë në Kuvend, këshilltari koleg nga radhët e PDK-së ka kërkuar që kjo të hiqet e gjitha, që dita e diele të jetë ditë pune, por nuk ka ardhur ashtu nga drejtori i DPZHE, por është sjellë që të punohet vetën në ato lokale që janë nën 50 m² dhe ashtu ne nuk kemi pranuar.

Sot jemi që propozimi në fjalë të kalojë, por vetëm kërkojmë të specifikohet data se deri kur do të zgjasë pezullimi i kërkuar i dispozitave të Rregullores të cilat ndalojnë punën e bizneseve ditëve të diela, pra deri në shtator, tetor apo deri kur për shkak që të mos shkojmë deri në pafundësi, përndryshe votat i keni për propozimin e cekur.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ato që i thonin ju janë më se të vërteta që dy herë është punuar në plotësimin ndryshimin e kësaj Rregulloreje dhe dy herë nuk ka qenë e përshtatshme për të gjithë dhe nuk ka pasur kompromis, jo sepse nuk është punuar ngase është punuar në të, por nuk ka qenë e përshtatshme, ka pasur mendime të tjera. Çështja tjetër e cila është shumë e rëndësishme, unë që tani këtu sot po ju ftoj që pasi të miratohet ky propozim, urdhëroni lirshëm e bëjmë një ekip nga Kuvendi i Komunës dhe bashkërisht edhe me Ekzekutivin i harmonizojmë qëndrimet dhe e përgatisim një rregullore që mendoni që është më e mira dhe të cilën do ta përkrahim të gjithë në Kuvend.

Unë e di shumë mirë që bizneset nuk janë vetëm interes i një subjekti politik dhe e di shumë mirë që të gjithë jemi të interesuar që çështja në fjalë të zhblokohet sa i përket lejimit të punës për bizneset e jo t'i dëmtojmë ato në funksionim, prandaj meqë kjo çështje është temë tani është mirë ta shtyjmë përpara. Sa i përket periudhës kohore deri kur të pezullohen dispozitat e cekura, për mua nuk paraqet problem qoftë deri në fund të muajit shtator qoftë e ndërlihim me fund vit në mënyrë që t'i japim vetës hapësirë dhe kohë për t'u ulur dhe analizuar dhe në fund të përgatitim një Rregullore të përbashkët, të përshtatshme dhe funksionale për të gjithë dhe ta shtyjmë përpara për miratim në Kuvend. Pra nëse dëshironi mund ta lëmë pezullimin deri në fund të muajit shtator, kohë kjo kur edhe bashkatdhetarët fillojnë të kthehen në vendet prej nga kanë ardhur për pushime, nëse dëshironi e lëmë deri në fund të këtij viti në mënyrë që deri atëherë bashkërisht me ju ta hartojmë një rregullore të re.

z.Avni Islami, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës pra pezullimi i punës ose në ditën e diele të punohet nuk është vetëm tani por ka qenë kërkesë edhe gjatë kohës së pandemisë dhe që atëherë pata propozuar që në një kohë të caktuar e sidomos në vendet turistike siç është Liqeni i Batllavës dhe pjesët e tjera ku janë pikat turistike të jetë ditë pune, e vërtetë që është një perceptim dhe një ditë e ndarë në mes asaj se a të punohet apo jo, për shkak se nëse punohet konsiderohet jo vetëm tek ne në Kosovë por në të gjitha vendet e botës shkelje e të drejtave të punëtorëve nëse punojnë të dielën, dhe unë me të vërtetë gjatë kësaj periudhe kam pasur kërkesa nga qytetarët dhe punëtorët që të mos punohet ditën e diel për shkak se shumë biznesmen dhe firma u'a bëjnë të pa drejtë punëtorëve dhe i shtojnë të punojnë të dielave dhe kështu u shkelën të drejtat e punëtorëve, mirëpo me që këtu ka hyrë në rend të ditës kjo pikë, jo vetëm që të lejohet puna për bizneset ditëve të diela, përkatësisht të pezullohen dispozitat përkatëse të Rregullores për një kohë të caktuar, mendoj që për periudhën siç e ceku edhe Kryetari, të merremi vesh bashkërisht dhe të jetë një datë të caktuar duke marrë parasysh edhe periudhën kur mërgimtarët vijnë për pushime në Kosovë e që unë konsiderohet se nga ky muaj që jemi e deri më 1 shtator është zonë turistike në një formë, prandaj unë e përkrahi propozimin që të pezullohen dispozitat e Rregullores që ndalojnë lejimin e punës së bizneseve ditëve të diela.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, e ceku edhe z.Fatmir Rudari që ne si Grup jemi për dhe e përkrahim propozimin në fjalë që edhe hyri si pikë e rendit të ditës, mirëpo desha të ndalem tek Inspektorati, nëse punohet ditëve të diela, a mund të sigurojë Komuna ose Inspektorati që për punëtorët të respektohet kontrata e punës e cila ju lejon punëtorëve një ditë pushimi gjatë javës. E dimë që shumë markete dhe shumë biznese tjera kanë punëtorë që i mbajnë në punë 7 ditë në javë, madje edhe nëpër festa punojnë nga 12 orë brenda 24 orëve, mendojmë që nuk është zbatuar sa duhet kjo dhe nëse Kryetari zotohet që Inspektorati do ta kryej punën me përpikëri, ne si Grup i PDK-së jemi për.

z.Bedri Maqastena, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit-DI, theksoi, lidhur me çështjen që u cekë rreth Drejtorisë së infeksionit, është çështje e niveli qendror që ta mbikëqyrë zbatimin e kontratave, jo e nivelit lokal, pra sa i përket të drejtave të punëtorëve, orarit të punës dhe çështjes së ditëve të pushimit për punëtorët, ne nuk kemi të drejtë të bëjmë me atë.

znj.Mimoza Stublla - Abdullahu, theksoi, atëherë unë do të propozoja që pezullimi i dispozitave sipas propozimit të Kryetarit të miratohet dhe atë deri në fund të muajit shtator dhe jo me vonë, për shkak se për punëtorët në sektorin privat përderisa Komuna nuk ka në dorë asgjë që t'i mbrojtë të drejtat e tyre, atëherë është e tepërt me i pas vetëm dy ditë pushim gjatë gjithë muajit, kështu që besoj që është e mjaftueshme që vendimi të jetë deri në muajin shtator.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, në mënyrë që ta racionalizojmë sa më shumë këtë dhe të ecim tutje, unë mendoj që është mirë ta lëmë fundin e muajit shtator, pra le të jenë të pezulluara deri në atë kohë dispozitat përkatëse të Rregullores që ndalojnë punën e bizneseve ditëve të diela. Ne si nivel lokal do të përdorim autoritetin ton brenda kompetencave që i kemi në këtë aspekt, meqë kjo është çështje ekskluzivisht e nivelit qendror dhe Inspektoratit të punës por megjithatë si Drejtori e Inspeksionit do të bëjmë përpjekje dhe në një formë do të kujdesemi maksimalisht më tepër në disa gjëra sa i përket respektimit të kontratave të punës për punëtorët në sektorin privat, mirëpo drejtpërsëdrejti nuk kemi të drejtë, por interesimin sigurisht do ta kemi.

Meqë është fundi i muajit shtator, deri në atë periudhë kohore kthehen edhe bashkatdhetarët në vendet e tyre ku jetojnë, unë besoj që kemi kohë të mjaftueshme të harmonizojmë bashkërisht qëndrimet me një plotësim ndryshim të Rregullores në fjalë, madje mendoj që ndoshta është mirë por edhe në interesin e juaj si grupe të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës që sot si Kuvend të caktoni nga një anëtar të Kuvendit i cili do të jetë pjesë përbërëse e grupi punues për hartimin e propozim rregullores së re për orarin e punës së bizneseve.

z.Agim Behluli, theksoi, personalisht e përkrahi idenë e Kryetarit të Komunës, mirëpo konsideroj se u stërgjatë paksa pa nevojë kjo çështje sepse dy here e ka sjell drejtori i DPZHE-së në Kuvend kurse sot nuk qenka ardhur fare në seancë, mirë ka bërë që nuk ka ardhur se ndoshta do të na e kishte pështjellur edhe më shumë këtë çështje.

Sa i përket orarit të punës dhe rregulloreve për punëtorët, është mirë që të merren vesh punëdhënës dhe punëmarrësi, madje ne jemi dëshmitar që ndoshta punojnë edhe 12 orë në ditë, por ata punëtorë paguhen, përndryshe nuk do të rrinin në punë, prandaj të mos merremi me atë. Unë po e përkrahi këtë idenë e pezullimit të dispozitave të cilat ndalojnë punën e bizneseve ditëve të diela, konkretisht që të lejohet puna këtyre ditëve për 3 muajt e ardhshëm, mirëpo pas kësaj periudhe në çoftë se ne jemi këtu, ju kisha lutur të sjellët një Rregullore e mirëfilltë dhe mos të merremi me të 3-4 herë nga 3-4 orë për gjëra shumë të thjeshta, pra të merren profesionistët të fushave përkatëse dhe të sjellët një rregullore tamam që i përmbush maksimalisht kërkesat dhe nevojat e të gjithëve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, atëherë unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht propozimin e Kryetarit të Komunës që të pezullohen përkohësisht deri më 30 shtator dispozitat e Rregullores për orarin e punës së bizneseve, të cilat ndalojnë punën e bizneseve të caktuara ditëve të diela, pra konkretisht ky propozim ka të bëjë me lejimin e punës së bizneseve edhe ditëve të diela deri në fund të muajit shtator.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 32 vota PËR, 1 votë KUNDËR dhe 2 vota të PËRMBAJTURA, u miratua propozimi i cekur, përkatësisht u vendos me këtë përmbajtje që:

-Të pezullohet përkohësisht zbatimi i dispozitave: neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2, të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020. -Kohëzgjatja e pezullimit, respektivisht lejimi që dita e diel të jetë ditë pune për subjektet afariste/bizneset, bëhet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 30 shtator 2021.

-Arsyeja e pezullimit të neneve të cekura, përkatësisht lejimi i punës edhe ditëve të diela për subjektet afariste/bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, është ofrimi i mundësive për afarizëm dhe qarkullim të bizneseve me qëllim të ngritjes së tyre si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga Pandemia Covid-19, furnizim dhe shërbime të rregullta për qytetarët në këtë periudhë verore kur pritet edhe ardhja e një numri të madh të bashkatdhetarëve për pushime në Kosovë.

-Për zbatimin të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e Komunës varësisht fushveprimtarisë dhe kompetencave përkatëse.

2. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më:

08 prill 2021; 29 prill 2021; 28 maj 2021; 15 qershor 2021

Njëzëri pa plotësim ndryshime apo vërejtje, miratohen në pako 4 procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës.

3. Korniza Afatmesme Buxhetore KAB 2022/2024 e Komunës së Podujevës

z.Faltum Osmani, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth KAB 2022/2024, ndër të tjera theksoi, sot para jush më lejoni të prezantoj Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për vitin 2022-2024, Korniza Afatmesme Buxhetore është njëra prej dokumenteve më të rëndësishme në të cilën paraqiten objektivat të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore me anë të të cilave synohet arritja e objektivat zhvillimore të Komunës së Podujevës. KAB është përpunuar në përputhje me procedurat buxhetore të dhëna nga Ministria e Financave përmes Qarkores Buxhetore për komunat si dhe financimi nga grandet qeveritare dhe kufijtë fillestar të buxhetit Komunal për vitin 2022 dhe parashikimeve të cilat janë miratuar nga komisioni i saj. KAB i prinë procesit të miratimit të buxhetit për vitin 2022 që do të bëhet gjatë muajit shtator, dhe në këtë dokument paraqiten prioritetet dhe projeksione buxhetore që buxhetit të Komunës do i ndihmojë në realizimin e këtyre objektivave zhvillimore gjithmonë duke u bazuar në ligjet që i përcakton Ligji për vetëqeverisje lokale dhe Ligji për Financa i pushtetit lokal.

Objektivat e Komunës së Podujevës përputhen dhe janë në harmoni me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës të shprehura në KAB dhe programe të qeverisë, përmirësimi i infrastrukturës në qytet, përmirësimi i infrastrukturës në fshatra, krijimi i një qyteti të zhvilluar me plan urbanistik, rritja e nivelit të arsimit duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e arsimit dhe duke u lidhur me ekonominë, zhvillimi i shëndetësisë duke krijuar shërbime cilësore për qytetarët, zhvillimi i kulturës dhe i sportit, ruajtja dhe përmirësimi i ambientit, zhvillimi i bujqësisë, zhvillimi i turizmit etj.

Për realizimin e këtyre objektivave pa dyshim është e domosdoshme mbështetja buxhetore bazuar në Qarkoren Buxhetore për Komuna për vitin 2022, Komuna e Podujevës për vitin 2022 ka një buxhet në vlerë prej 23,449,520.00 €, për vitin 2023 vlerë 24,658,512.00 € dhe për vitin 2024 një buxhet me vlerë 25,589.522.00€. Këto limite buxhetore janë të përcaktuara në Qarkoren Buxhetore të cilat aprovohen nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, shumica e këtij buxheti është nga granti i përgjithshëm, granti për arsim dhe granti për shëndetësi si dhe të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës që janë të planifikuara me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë së Financave me vlerë 1,356,216.00 € që fatmirësisht në realitet do të jetë 2 milion euro dhe ne si Komunë dhe si DBF gjatë fazës kur vije Qarkorja e dytë do të kërkojmë që ky limit për të hyrat vetanake të rritet për arsye se edhe trendët e pranishme tregojnë për të hyra shumë më të mëdha se sa që janë të planifikuara me Qarkoren e Ministrisë së Financave, e që i bije që rrjedhimisht me buxhetin e vitit 2022 do të jenë edhe më shumë projekte për arsye se do të ketë më shumë buxhet kur të miratohet buxheti për vitin 2022. Për vitin 2022 buxheti do të jetë 23,449,520,00€ dhe do të përbëhet nga kjo strukturë e shpenzimeve si në vijim, për paga do të jenë 12,525,782.00€, për mallra 2,489,489.00€, për komunale 420,000 €, për subvencione 860,50 € si dhe për investime kapitale 7,154,199.00€.

Në këtë kornizë buxhetore të vitit 2022-2024 për dallim nga vitet tjera është një territor shumë më i madh i këtyre fushave, arsimit, ekonomisë kulturore dhe sportit dhe projekteve zhvillimore në fushën e infrastrukturës urbane, politika dhe prioriteti në këto fusha në krahasim prej viteve të kaluara më së miri shpjegohen përmes numrave, pra përmes shumës së planifikuar për investime në këto fusha në krahasim me vitin 2021, buxhet ky i miratuar në të kaluarën, për arsim në kodin buxhetor, përmirësimin e infrastrukturës shkollore për vitin 2022 parashihen të investohen 634.000.00€ për dallim nga viti 2021 që janë vetëm 97,582.00€ pra 6.49 herë më shumë e që është një rritje e jashtëzakonshme që tregon më së miri prioritetet e arsimit që mendoj se është shtylla kurriore e zhvillimit të shoqërisë sonë. Në kategorinë me mallra në arsim janë 570,246.00€ që për vitin 2021 ndërsa për vitin 2022 do të jenë 701,039.00 €, pra 26.44% më shumë, në kategorinë e subvencioneve përkatësisht të bursave janë të planifikuara 60.000.00€ për dallim nga 40.000.00€ të cilat janë në

vitin 2021. Projektet në fushën e shëndetësisë janë shumë të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore dhe për vitin 2022 parashihet vazhdimi i ndërtimit të QMF-III, renovimi i objekteve shëndetësore dhe pajisjeve mjekësore si dhe një projekt shumë i rëndësishëm që parashihet të filloj në vitin 2023 është objekti për persona pa përkujdesje familjare dhe persona me nevoja të veçanta, gjithashtu në kategorinë e subvencioneve ka rritje nga 70.000.00 € në 90.000.00€ pra një rritje prej 28.57%. Në fushën e ekonomisë kemi një buxhet prej 440,000.00€ për dallim nga viti 2021 ku janë të planifikuara 140.556.00€, pra një buxhet prej 2.94 herë më i madh sesa në vitin 2021 ku parashihen investime në vlerë 200,000.00€ në zonën ekonomike ku së bashku me shpenzimet e tjera për kthimin e pronës ku parashihen të ndërtohet zona ekonomike në pronën Komonale mendoj që është një projekt që do të marr jetë dhe do të jetë diçka shumë e madhe për zhvillimin e prodhimit në Komunën e Podujevës.

Gjithashtu në përkrahjen e DPZHE është planifikuar edhe rritje të subvencioneve ku 80,000.00€ parashihen për subvencionin e normës së interesit të bizneset prodhuese në fushën e kulturës dhe sportit për investime kapitale në vlerë 340,000.00€ ndërsa për vitin 2021 kanë qenë të planifikuara 223,550.00€ pra ka një rritje të buxhetit prej 46.5%, mandej në fushën e kulturës parashihen fonde për fillimin e ndërtimit të shtëpisë së kulturës ku do të jetë bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe planifikim buxhetor për ndërtimin e fushave rekreative sportive, galerinë e arteve si një projekt shumë i rëndësishëm që besojmë që është ndoshta edhe për herë të parë që parashihet e kodin buxhetor të Komunës së Podujevës buxhet për trashëgiminë kulturore.

Në lëmin e Urbanizmit parashihen projekte zhvillimore ku qytetit të Komunës sonë do t'i japin një dimension tjetër të zhvillimit dhe synimin e saj për një qytet të zhvilluar me plan urbanistik, me ambient të pastër dhe hapësira rekreative, si projekte që parashihen me KAB që janë të shprehura në themelet e një qyteti qysh e meriton Podujeva janë ndërtimi i rrugës “Skënderbeu” dhe rrugës “Xhemajl Mustafa” në vlerë 1,193,000.00€, ndërtimin e rrugës lidhëse nga magjistrallja Podujevë-Prishtinë me rrugën “Vëllezërit Frashëri”, pastaj rrugën “Shaban Shala” dhe “28 Nëntorin”, ndërtimi i rrugës lidhëse të rrugës “Skënderbeu” dhe rrugës “Zahir Pajaziti” në vlerë 500,000.00€, mandej ndërtimi i rrugës përgjatë hekurudhës në vlerë prej 800,000.00€, ndërtimi i unazës së jashtme të qytetit në vlerë prej 1,44,650.00€, rregullimi i hapësirave në brigjet e lumit “Llap” në vlerë prej 400,000.00€, ndërtimin e shtigjeve për biçiklistë në vlerë prej 400,000.00€ që është mbështetje për një ambient më të shëndosh.

Pra të nderuar asamblist, rritja e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës shkollore për 4.66 herë, rritja e investimit në ekonomi për 2.94 herë, rritja e investimeve për kulturë për 56.5%, investime në projekte madhor dhe infrastrukturë urbane që i japim qytetit dhe Komunës kulturën që është ideal dhe përpjekje jonë e përditshme. Ne kemi qenë të hapur gjatë ditëve për propozime nga gjitha Grupet e asamblistëve dhe nga qytetarët ku kemi bërë edhe dëgjimet publike, vërejtjet dhe për sugjerimet eventuale jemi të hapur për të bashkëpunuar edhe propozimet jemi shumë të gatshëm t'i votojmë kur të vije për miratimin e buxhetit kur dihet se KAB më shumë është një dokument që i paraprin dhe si dokument merr formën ligjore kur të miratohet nga kjo asamble, ju ftoj që ta mbështetni këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore.

z.Mehmet Gashi, theksoi, unë edhe në KPF i kam pasur disa vërejtje, mirëpo këtu para Kuvendit kisha dashur që secili ta jap opinionin e tij rreth KAB-it për vitin 2022-2024, dokument ky i cili tani në këtë fazë është propozim dhe është një dokument shumë i rëndësishëm i cili pasqyron të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën 2022-2024 e cila duhet të jetë në përputhje të plotë me KAB-in e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Qarkores Buxhetore për Komunitatet e qara që janë të miratuara edhe nga Komisioni i granteve, Komisioni i granteve për komuna ku për bazë e kanë numrin e banorëve që i përkasin me territorin dhe kritere tjera.

Komuna e Podujevës siç e dini për nga sipërfaqja është Komuna më e madhe në Kosovë me 663 km², kriter kryesor i ndarjes së buxhetit për komuna ka qenë numri i banorëve me 89%, Komuna e Podujevës pas luftës është vlerësuar se ka 117000 banorë si komunë e 3-të në Kosovë pas Prishtinës dhe Prizrenit, kurse pas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 ka dalë e 7-ta me 87546 banorë.

Në propozim buxhetin e Komunës sipas Qarkores Buxhetore 2021, është paraparë një buxhet prej 23,449,520.00 € apo 1% më shumë sesa në vitin 2020 që është 22,930,305€ janë nga ganti i Qeverisë, do të thotë janë 22,930,304 ndërsa nga të hyrat vetanake kemi një buxhet të realizuar prej 1,356,216.00€, të hyrat vetanake apo 60,385.00€ më pak sesa në vitin 2021. Në propozim buxhetin për vitin 2022 në shumën prej 23,449,520.00 €, shuma buxhetore prej 12,525,782.00€ apo 53.4% që shkojnë për paga, 2,489,449.00€ apo 8.6% për mallra dhe shërbime 420,000.00€ apo 1.8% për shpenzime komunale, pastaj 860,50.00€ apo 3.6% për subvencione, ndërsa 7,240,199.00€ apo 30.6% për investime kapitale. Të nderuar të pranishëm për ne si anëtarë të kuvendit por edhe për të gjithë qytetarët e Komunës është e rëndësishme që projektet për investime kapitale të jenë sa më transparente, ndarja e drejtë dhe e arsyeshme duke u bazuar në ligjin për financat e pushtetit lokal, ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe ligji për vetëqeverisje lokale.

Të nderuar të pranishëm vërehet se në propozim KAB 2022/2024 nga faqja numër 27 ku bëhet fjalë për programin Komunal, investimet publike apo si quhet këtu e përshkruan projektet prioritare për vitin 2022/2024 me theks të veçantë për vitin 2022, emërtimi i projekteve nuk është në frymën e institucioneve financiare dhe transparente, pothuajse pjesa dërmuese e projekteve janë të përgjithësuara, të pa qarta dhe jo transparente për çka edhe LVV-ja çdoherë ka proklamuar një transparencë të plotë, unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kështu siç është kam vërejtur se keni një përkrahje nga grupi i këshilltarëve i LVV-së. Sa i përket projekteve për vitin 2022 në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit janë paraparë 22 projekte, vetëm 3 projekte dihet cila rrugë është e planifikuar, të gjitha të tjerat janë të përgjithësuara, shembull, asfaltimi i disa rrugëve në qytete, asfaltimi i disa rrugëve në fshatra, gjithashtu edhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë paraparë 13 projekte e që 10 prej tyre nuk dihet vendi i saktë apo rruga. Në Komunën e Podujevës të gjitha rrugët janë të regjistruara, të emërtuara dhe me gjatësi, andaj Ekzekutivi është dashur në mënyrë të qartë dhe transparente t'i specifikoj saktë cila rrugë, gjerësia e saj, gjatësia, vendi, qyteti apo fshati. Unë i kam përkrahë këto projekte dhe dëshiroj vetëm t'i bëjë edhe disa propozime tjera që janë shumë të rëndësishme dhe kanë qenë edhe në kohën e mëparshme siç është zona e ndryshme lidhëse kufitare, shembull asfaltimi i rrugës në Murgull lagjja Marincë rruga rreth 3.5 km, dhe isha atje dhe vetëm me mjete transportuese traktor mund të kalohet nëpër atë rrugë, është e pa kalueshme, janë 7 apo 8 familje atje duke jetuar kanë zhvilluar edhe bizneset e tyre e sidomos bletari dhe blegtori kështu që nëse duam t'i krijojmë kushte ne është dashur t'i kemi parasysh, pastaj kemi kërkesën për asfaltimin e rrugës në fshatin Tërnavicë e që këtu e kemi edhe kolegun z.Ragip Fetahu që e dinë gjendjen më mirë se si është atje, ku familjet gjatë periudhës së dimrit duhet të kthehen në qytet për shkak të rrugëve të cilat janë në gjendje të keqe, ndoshta nuk e dini të gjithë por vetëm brenda një viti me bletë kanë mund t'i marrin deri në 10000 kg mjaltë ato 7-8 familje që janë atje, prandaj është mirë t'i japim përkrahje e jo të importohet mjaltë kur dihet se në Kosovë 95% importohet vetëm 5% eksportohet kështu që është mirë t'i stimulojmë edhe bizneset e bletarëve, shembull në fshatin Marincë nuk ka urë për të kaluar me makinë, vetëm për këmbësor ka mundësi për automjete është e pa kaluar përmes lumit Llap, gjithashtu edhe në pikën kufitare në fshatin Dumnice nga lagjja e Jasharve edhe aty kemi rrugën e pa asfaltuar. Sa për të mos thënë ndokush se po bëjë vetëm kritika sepse vërejtje kemi pasur edhe në

periudhat tjera unë shembull e marr fshatin Dobërdol, vitin e kaluar janë miratuar disa rrugë nuk e kam ditur se cilat janë ato rrugë dhe kur kanë ardhur votuesit e mijë dhe më kanë pyetur se a është sërish në planifikime për t'u ndërtuar, unë iu kam thënë po kur kanë shkuar tek drejtori ju ka thënë që jo, sepse i ka marrë parasysh rrugët sekondare dhe nuk i ka marr ato primare, prandaj për të mos ndodhur kjo, emërtimi i rrugëve është bërë dhe menjëherë dihet se cila është ajo rrugë, e jo me vendos rrugë të ndryshme kur kemi mundësi t'i specifikojmë.

Buxheti dihet përafërsisht, po ashtu e dimë që vitin e kaluar kanë qenë auditorët e nivelit qendror, kanë kërkuar projekte të ndryshme dhe është dashur ndoshta gjysmë dite të gjenden, shembull Podujeva i ka dikund rreth 300-400 rrugë dhe nëse ne themi “rrugë të ndryshme në qytet” dhe vjen një auditor dëshiron t'i kontrolloj se ku është, duhet të kërkohet me zyrtarët ku ndodhet ajo rrugë, prandaj për të mos pasur keqpërdorime, këtë po e them sepse sa kam qenë unë drejtor i DPUMM në vitet 2010-2014 dhe çdo herë kanë qenë emërtimet e rrugëve, shembull, fshati, lagjja, pastaj kanë qenë emërtimet e rrugëve ashtu siç janë edhe tani emërtimet dhe shumë pak merr punë, ndoshta 2-3 ditë me zyrtarë të Drejtorisë përkatëse dhe mundet me qenë shumë transparent, kështu që unë e di se LVV çdo herë ka thënë për projekte vetëm asfaltime, projekte të përgjithësuara prandaj të njëjtat vërejtje po i bëjë edhe unë tani dhe nëse Ekzekutivi i pranon këto vërejtje në raport që t'i përmirësoj këto e jo kështu të përgjithësuara sepse unë nuk e di çka do të thotë në mënyrë të përgjithësuar rrugë, fshatra, nuk e dimë nëse pyetmi nga ndokush, ndoshta e dinë drejtori i DBF-së se ku dëshiron t'i orientoj, në një familje apo në rrugë sekondare nuk e di, por këtë projekt KAB e kam unë, edhe pse drejtori i DBF-së e tha se nuk është definitiv i gjithë ky draft për shkak se buxheti miratohet deri në fund të muajit shtator të këtij viti, mirëpo kjo është si bazë dhe duhet të plotësohen pikat përkatëse dhe të dërgohen në Ministri, të arsyetohen dhe të mos ndodhin këto lëshime / gabime, andaj kërkoj që të merren parasysh.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, KAB është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Kuvendi i Komunës që do të jetë bazë për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimit të prioritetëve të shpërndarjes së burimeve Komunale për periudhën 2022-2024, pra është dokument i cili paraqet koherencën, koordinimin dhe lidhjen funksionale në mes projekteve të përcaktuara me dokumentet strategjike komunale për zhvillimin në njërin anë si dhe për përfshirjen e këtyre koncepteve specifike në projekt zonën buxhetore në periudhën afatmesme.

Ky hartim i KAB është përpiluar së bashku me qytetarët e Komunës së Podujevës, i kemi mbajtur për herë të parë 4 debate në lokalitetet kryesore të llapit në orë jashtëzakonisht të përshtatshme kur qytetarët kanë mundur të jenë pjesë e bashkëpunimit, pra ka filluar një praktikë e mirë e bashkëpunimit në mes të Komunës dhe qytetarëve. LVV-ja vazhdimisht në kornizat e kaluara dhe në plan programin e saj qeverisës ka kërkuar që t'i ipet prioritet arsimit, prodhimit vendor, kulturës dhe sportit, zhvillimit, dhe të gjitha këto në bazë të limiteve që lejon Qarkorja Buxhetore i kemi këtu, prandaj si Grup i LVV-së e mbështesim këtë dokument i cili sqaron objektivat buxhetore në përmirësimin e infrastrukturës në qytet e fshatra, një qytet të zhvilluar me plan urbanistik, ngritja e nivelit të arsimit duke krijuar kushte të mira për zhvillimin e arsimit, shëndetësi me shërbime cilësore për qytetarët, rritja e mirëqenies sociale, përkrahja e bizneseve, zhvillimi i kulturës, zhvillimi i industrisë dhe bujqësisë, mirëpo kemi edhe ne një vërejtje tek detajizimi i projekteve mirëpo për shkak të kësaj herëve tjera do të vije me qartë prandaj uroj dhe shpresoj që këto projekte të realizohen.

z.Bashkim Sylja, theksoi, krahasimi i drejtorit të DBF për planifikimin e vitit 2021 me vitin 2022 nuk më është dukë shumë korrekt, të gjithë e dimë që viti 2020-2021 kemi qenë vit i pandemisë dhe nuk është korrekt. Sa i përket KAB 2022 -2024 unë do ta potencoj vetëm për vitin 2022 sepse për vitet tjera mendoj që kjo kornizë do të ndryshoj dhe do të miratohet edhe vitet tjera.

Në prioritete shihet qartë se shumica e mjeteve janë orientuar në DPUMM dhe infrastrukturë publike kështu që të dyja së bashku përfshijnë një shumë prej 5,155,000.00€ nga 7,104,000.00€ sa është totali ose 72% e buxhetit total, kështu që mendoj që prioritetet e kësaj qeverisje janë vazhdimësi e qeverisjes së kaluar, në shëndetësi janë paraparë 595,000.00€ së paku nuk janë specifikuar se cilat objekte shëndetësore do të rinovohen, jeni në dijeni se i'u kemi dhënë vërejtje edhe qeverisjes së kaluar për mos përkrahim të projekteve se ku do të investohet, pastaj në bujqësi janë paraparë 430,000.00€, vitin e kaluar kemi ndarë një buxhet prej 30,000.00€ si fond për të ndihmuar bujqit për shkak të dëmtimit nga reshjet dhe kushtet atmosferike, kurse tani nuk keni planifikuar e që si ide e kemi përkrahur të gjithë në Kuvend. Sa i përket planifikimit dhe ndarjes buxhetore për Zyrën e Kryetarit, Kuvendin, administratën dhe Drejtoritë tjera, planifikimi i shpenzimeve është shumë më i ulët se sa që ka bërë qeverisja e kaluar me KAB 2020-2023, me përjashtim të DPZHE-së.

Edhe investimet nëpër disa fshatra i keni planifikuar kurse në fshatin Gllamik janë 40,000.00€ dhe nga këto as planifikime për fazën e dytë të ndriçimit e as për tretuar, kështu që mbi 5 milion euro investime kapitale që ka planifikuar kjo qeverisje 40,000.00€ i ka planifikuar për fshatin Gllamnik, ndërsa me KAB 2020-2023 për asfaltimin e rrugëve kanë qenë të parapara 350,000.00€ pa përfshirë ndërtimin e trotuareve dhe pa përfshirë ndërtimin e pjesës së dytë të ndriçimit publik, ka edhe shumë fshatra tjera që nuk është paraparë asnjë cent për rregullimin e rrugëve, kështu që ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së jemi kundër kësaj kornize.

z.Adnan Zymeri, theksoi, kompetenca profesionale e deklaruar me një diplomë fakulteti është hiç gjë, kur sheh veprimet amatoreske në përditshmërinë e angazhimeve që bartë posti publik. Krejt kjo do të ishte e pa rëndësishme po të flisnim për individ, por po flasim se kush po udhëheq me portofolin e një shtëpie të përbashkët të quajtur Podujevë.

Inkompetenca nënvlerëson edhe dokumente të një rëndësie strategjike siç është Korniza Afatmesme Buxhetore e cila hartohet fillimisht duke i konsultuar dhe lexuar dokumentet tjera strategjike në veçanti Strategjinë Zhvillimore Komunale, pa anashkaluar edhe strategjitë tjera të Komunës sonë. Në rastin më të keq, siç është rasti këtë herë me Komunën tonë në emër të ndryshimit epokal, anashkalohet një model i KAB-it të miratuar në të kaluarën nga Komuna e Podujevës, model i hartuar së bashku me USAID-in Amerikan dhe kopjohet për mos tu shprehur me vrazhdë modeli i KAB-it të vitit 2019 dhe 2020 të Komunës së Prishtinës dhe për t'i ikur kopjimit nga profesori Shpejtëm, bëhen në këtë dokument disa ndryshime të vogla duke e deformuar në tërësi.

Mos të harrojmë që ky model është marr nga Shpend Ahmeti që sa ishte në VV po qeveriste mirë e në vitin 2019 që nuk është më po qeverisë keq. Do të thotë kopje e keqe e cila do të faktohet gjatë shpjegimit në vijim.

Korniza Afatmesme Buxhetore është dokument që fillimisht hartohet për tu shërbyer investitorëve potencial dhe publikut në përgjithësi, dhe për tu dukur më ndryshe se modeli i Shpendit, në kornizën e paraqitur para nesh hiçen si të parëndësishme informatat më bazike rreth Komunës sonë si: numri i bizneseve, numri i OJQ-ve, numri i popullsisë, sipërfaqja etj, pastaj hapat që duhet ndjekur nga fillimi i hartimit deri tek miratimi i tij, me afate të matshme kohore edhe kjo pjesë hiqet. Nuk ka të hartuar një vizion dhe synime të qarta që e përshkruan Komunën e Podujevës ku do të arrij në tri vitet e ardhshme, këto synime janë zëvendësuar me objektivat që i ka paraparë Komuna e Prishtinës. Për tu vërtetuar shikoni faqet 2,3,4,5 të këtij materiali. Se ka shpërputhje të mëdha mes objektiveve dhe parashikimeve që mundësojnë arritjen e këtyre objektiveve mjafton të shikosh në faqe 4, objektiva b) është rritja e të hyrave vetanake ndërsa te parashikimi i të hyrave për vitin 2022 faqe 6 tabela 2 parashihet zvogëlim i të hyrave nga lejet e ndërtimit nga 180.000.00€ në 105.000.00€, të krijohet përshtypja se ne po futemi në pandemi e jo se po dalim nga ajo. Të nderuar koleg, jam shumë kurioz ta di si ka logjikë të parashikohet zvogëlimi i të hyrave nga lejet e ndërtimit kur jemi

në fazën e aplikimit për legalizimin e ndërtimeve pa leje si dhe kërkesave për ndërtime të tjera të larta. Ka logjikë të zvogëlohen parashikimet për taksat administrative por nuk ka logjikë të parashikohet zvogëlim për leje të ndërtimit dhe taksa për regjistrimin e automjeteve. Meqë në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Prishtinës të vitit 2019 dhe 2020 shihet qartë që disa Drejtori në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nuk kanë fare buxhet, jo pse nuk shpenzojnë, por me sistemin “masi krejt edhe na”, edhe Komuna e Podujevës nuk ka planifikuar buxhet për mallra për Zyrën e Kryetarit, Zyrën e Kuvendit, Zyrën për Komunitete dhe Kthim, Administratën e arsimit dhe shëndetësisë, dhe krejt për hir të transparencës kjo shihet në tabelën e buxhetit faqe 9. Ndoshta në KAB-in e ri të Komunës së Prishtinës ndryshojnë të dhënat, mirëpo tash edhe ai është në procedurë të miratimit dhe nuk e dimë.

Nga faja 10 e këtij materiali deri në 23 në vend se të kemi vizion, mision dhe synime të qarta të Drejtorive përkatëse kemi vetëm përshkrim të detyrave të tyre. Ndoshta kur thash se është kopje e pastër tingëllojë tepër politike, mirëpo në këtë dokument përfshihen përshkrimi i detyrave të gjithë Drejtorive të Komunës së Podujevës, përveç Drejtorisë së Inspeksionit që thuhet, po citoj: *mbikëqyrë dhe inspekton të gjitha dukuritë negative që hasen në Komunën e Prishtinës, këtë e gjeni në faqe 21*, përveç gabimeve në përmbajtje, kolegët që kanë qenë në Kuvend nga fillimi i mandatit e din që Vetëvendosje ka kritikuar shumë edhe për gabimet drejtshkimore duke përdor gjuhë fyese se pushteti i atëhershëm nuk dinte të lexonte, se di nëse e keni lexuar të nderuar koleg faqen 19 të këtij dokumenti. Për fund, por jo më me pak rëndësi është lista e projekteve të planifikuara, për të cilën gjithmonë e keni akuzuar LDK-në si qeverisja e asfaltit dhe kanalizimeve. Drejtoria e Urbanizmit që merret me asfalt e ka zvogëluar buxhetin për 1666 € krahasuar me buxhetin aktual, ndërsa ajo e shërbimeve publike që merret me kanalizim e ka shtuar buxhetin për 115.000.00€, çfarë qeverisje jeni ju, ku kanë mbet propozimet që Vetëvendosje i bënte duke pretenduar miliona për bujqësi e shëndetësi. Ky Ekzekutiv atëherë ato propozime nuk i ka dëgjuar, por si duket as tash nuk ju kanë dëgjuar. Na thoshit se në mungesë të transparencës nuk po i publikoni emrat e rrugëve që duhet shtruar duke i specifikuar ato rrugë, kjo qeverisje shkon edhe më larg, jo duke specifikuar emra por duke bërë bashkë fshatra si për shembull asfaltimi i disa rrugëve në Rep, Brecë dhe çka të mbesin në Shtedim, dhe përveç kësaj nuk dihet burimi i financimit por vetëm shuma e projektit. Me të vërtetë ky është ndryshimi. Të dashur dhe shumë të respektuar qytetar, krejt kjo që po e them, nuk ka të bëjë me asnjë emër të përveçëm, por vetëm me funksionet e bartësve të përgjegjësive të nivel lokal, përderisa ky dokument paraqet inkompetencë të plotë profesionale, kopje të planifikimeve të një Komune tjetër, mungesë të transparencës dhe specifikimeve dhe planifikim sa për të thënë që e bëjnë këtë dokument të keq, unë do të votoj kundër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjova me vëmendje paraqitjen e drejtorit të DBF-së por edhe diskutimet e asamblistëve të subjekteve politike dhe e shikova së pari në hap me kërkesën në KPF që ishte nga z.Mehmet Gashi, që deri në ardhjen e seancës së ardhshme miratimi i atij dokumenti të bëhen saktë specifikimet e investimeve nëpër vendet rurale dhe urbane.

Duke mos dashur t'i potencoj ato që u ngritën nga të tjerët, ky institucion dhe Kryetari i Komunës po harron se për mos kryerjen e detyrave nga ana e drejtorëve të tyre nuk po kalojnë proceset sepse nuk mund të kalojnë proceset vetëm ashtu siç dikush i bije këtu dhe mendon se nuk i lexon ndoshta askush, por dikush konkret merret me këto dokumente sepse është obligim i secilit prej nesh që t'i shikojmë dokumentet dhe nuk jemi kundër investimeve por po ua shtrojmë pyetjen direkt, unë edhe në të kaluarën kam thënë që nëse kthehem me kokë mbrapa ashtu me kokë mbrapa mbesim. Nuk dëshiroj të flas tani se çfarë ka bërë LDK, as se çka bënë z.Shpend Ahmeti në Prishtinë, por më intereson se çka bënë në Podujevë njeriu që është kompetent.

E di që drejtori i DBF-së pak edhe si në të kaluarën i ka sjell këto shifra, këto emra ashtu siç ja sjellin në Drejtori, por për të marr miratimin ky dokument duhet pak me i dhënë përgjigje pyetjes sonë, shembull Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi në debatin me qytetar javën e kaluar qytetarëve iu thoshte se më ka bllokuar opozita, por nuk i tregonte që drejtori i tij nuk e kryen punën, e tani se si del në kamera këtu ne flasim dhe opinioni ta marr ashtu, kurrë nuk e dëgjova në atë debat që e pati pyetjen për biznese, për atë rregulloren e dështuar si shkas direkt i drejtorit përkatës e që tani të gjithë drejtorët i ka këtu kurse atij i kishte thënë mos hajde në sall, mandej nuk tregonte që e gjithë kjo Drejtori nuk ka mund të arrij një konsensus për Rregulloren përkatëse, për punën e juaj, as në rregullore çfarë e ka sjell ai është dashur t'ju tregoj që kjo rregullore është diskriminim racor dhe vetëm që nuk i vendos në litar edhe bizneset edhe punëtorët, prandaj Drejtoritë duhet t'i kryejnë punët e tyre e pastaj ta marrin votën këtu.

Tani KAB 2022-2024 ka ardhur si dokument orientimisht 90% duhet të jetë i orientues i buxheteve dhe i projekteve për vitet e ardhshme, nëse institucioni punon siç duhet, por ne nuk mundemi të miratojmë këtë KAB, shembull, në asnjë prej rrugëve të fshatrave dhe qyteteve nuk e dimë ku kanë me hyrë këto mjete, ose siç e ceku asamblisti i më hershëm që ka me nga 5 fshatra që janë bërë bashkë për investime me një shumë të planifikuar të mjeteve. Nëse drejtori përkatës mund të del këtu dhe të thotë se ne kemi kërkuar që deri të vije puna në seancë me na caktuar sa mjete kanë për të hyrë, sepse këtu ndahen mjete buxhetore, ne e dimë sa kushton kilometri i asfaltit për tu përfunduar siç duhet me gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe më nuk mund të punojmë ashtu siç është punuar në vitet 99 që Kosova ka qenë në baltë, bëni rrugët kur të kryhet më aty investim nuk mund të bëhet për një kohë të gjatë, duhet të vendoset kanalizimi, gypi rezervë për ujësjellës sepse nuk është me rëndësi a ka ujë tani por në të ardhmen duhet të ketë, kurse tani këtu përgjigje nuk mund të na jepet, apo nëse janë hequr mjetet e parapara në KAB-in e kaluar siç e potencoj këshilltari nga PDK z.Bashkim Sylja, pra nëse kanë qenë të parapara 150,000.00€ për rrugë në fshatin e cekur kurse tani 10,000.00€ dhe janë hequr edhe investimet e shërbimeve publike dhe të tjera për të gjitha duhet të japim arsyeshmërinë pse janë hequr. Çështja tjetër, shembull Kryetari nuk u tregonte qytetarëve në atë takim se edhe kjo kërkesa që ishte që të hyjë në rend dite si pikë shtesë për të cilën unë isha që të hyjë si pikë e fundit se as vetë Kryetari nuk ka qenë në gjendje të debatoj për atë rregullore, mirëpo e vendosëm të parën vetëm që të mos thotë po më bllokoi opozita, por unë isha dje në Orllan dhe e pash Kryetarin atje, kurse Rregullorja për orarin e punës së bizneseve është në funksion mirëpo atje kishte pasur biznese - ushqimore duke punuar edhe pse ishte e diele, dua të them se Kryetari i Komunës ishte aty, Rregullorja në fuqi dhe vetëm një apo disa biznese aty të punojnë, nuk më intereson fare kush është, por është detyrë e Inspeksionit të qëndroj në terren. Pastaj është Vendimi i Ministrisë së Ambientit që ka të bëjë me veturat që parkohen në rrugë dhe çështje tjera, por dje unë isha atje dhe ishte edhe vet Kryetari z.Shpejtim Bulliqi dhe kemi parë rrugët tek liqeni se çka është bërë aty, mund të shkojmë qysh tani edhe me kamerë, së bashku të gjithë ne përfshirë drejtorin e Inspeksioni, Nënkryetaren e Komunës e këdo qoftë, lirshëm e them se janë 4-5 kamionë mbeturina në Orllan, nuk është punë e opozitës ajo, as e asamblistëve e as e Kryesuesit të Kuvendit, është punë dhe detyrë e Kryetarit të Komunës ta përfundoj këtë punë. Pastaj Kryetari i Komunës nuk i tregonte qytetarëve në atë takim që me marr votë pro për këtë KAB që e ka paguar 250€ një pemë dekorative 5-8cm dhe sa kam vërejtur një është i thatë tjetri është i njomë, për çka mund ta marrim kamerën dhe së bashku edhe me DSHPMM të dalim në teren ku do të shohim se në pjesën e sipërme një është tharë tjetri është i plotë, ndërsa janë paguar 250€ për një dru dekorativ në Komunën e Podujevës, e kjo është problem, institucioni kur parashikon mjete del e mat çmimin e tregut. Më besoni që vetëm për të mos folur individualisht, se as sot nuk do ta mbështetja me votë propozimin që të lejohet puna ditëve të diela për 3 muaj po mos të kishin qenë disa që vijnë

nga diaspora dhe që kanë pak dëshirë të relaksohen në këtë pushim, përse nuk do e mbështetja sepse nuk besoj që do të kisha përgjigje nga Kryetari po që se do ta pyesja kënd e keni kontaktuar prej bizneseve në terren, ashtu siç nuk ka pasë përgjigje as drejtori i Drejtorisë përkatëse, e që mendoj se është dashur të takohen dhe kontaktohen të gjitha bizneset, sindikata e sektorit privat dhe përfaqësuesit e punëtorëve, madje për 5 ditë me marr opinionin e tyre se çka të bëjmë për ta marr votën këtu. Nuk mundemi i nderuar drejtor i DBF-së ta kalojmë këtë KAB sepse i ke kërkuar, shembull në një pikë të dokumentit 500,000.00€ për ndërtimin e infrastrukturës në disa pjesë të qytetit, kurse qytetarët e Podujevës që jetojnë në qytet duhet ta dinë se ato 500,000.00€ a hyjnë në zonën veri, jug apo në qendër, dhe çka ka për tu bërë aty sepse është shumë goxha e madhe për Podujevën janë gjysmë milion euro që dikush duhet të dijë se çka ka për tu bërë në mënyrë që pastaj të jepet vota për personalisht po e them për veten time. Mandej për planifikimin buxhetor siç e keni shkruar, asfaltimi i disa rrugëve, më së shumti ka fol LVV-ja për shpenzimet pa specifikime duke thënë se i vendosëm emrat por i keni hequr, por kush ju jap të drejtë juve të mos përmendni emrat e rrugëve që do të shtrohen, (cilado parti që del këtu thotë unë jam njëshi) por Kryetari le ta marr përgjegjësin se çfarë përgjigje ka për t'ju jap sektorit privat dhe punëtorëve që nuk i'u ka jap asnjë ditë pushim bizneseve, ai duhet t'i thotë këtë sepse ai e ka marr votën dhe ai duhet ta dijë, por votën time nuk e merr kështu sepse nuk po dinë të japësh përgjigje ti drejtor. Unë po flas së pari për fshatin prej nga vije, janë 5 rrugë prioritare dhe tani shtroj pyetje cila rrugë në fshatin Dyz ka për tu shtruar, ma jep emrin e rrugës, 5 rrugë janë prioritare të tjerat janë shtruar nga niveli qendror për shkak të neglizhencës politike, të gjitha i ka shtruar PDK prej nivelit qendror, 20 vite i diskriminuar politikisht, si në kohën e Xhaxhit, prandaj pyes cilën rrugë keni për ta shtruar në fshatin Dyz a dini të më tregoni emrin e rrugës, sa është kostoja e atyre rrugëve dhe sa kilometër rrugë janë paraparë të shtrohen në një fshat. Dyshoj se nuk e dini, por kur nuk e dini ju kush e din këtu, a e din qytetari apo po dëshironi t'i bartni mjetet ku të dëshironi e për çka nuk mund të merrni votën e shumicës.

Tani e nderuar Nënkryetare e Komunës sepse Kryetari nuk është këtu prezent dhe i nderuar Kryesues i Kuvendit, kërkoj që në seancën e ardhshme të sjellët një raport i detajuar prej Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, meqë tani drejtori i DBPZHR qenka këtu sepse në raportin e kaluar të kësaj Drejtorie z.Bahri Selimi drejtori i Administratës është munduar ta jap një përgjigje. Nuk është problem i yni as pse dështon projekti i bletarisë, as pse dështojnë serrat që prej 150 m i keni sjell në 50 m edhe ai ka dështuar, pastaj as pse dështon çështja e rregulloreve kur një drejtor mendon që vetëm deri t'i marr votat dhe pastaj ulet në atë karrige dhe nuk ka për të dalë prej zyrës, as pse janë mbeturinat në Orllan dhe pse është bërë ajo avari, madje në sy të Kryetarit të Komunës që ishte në restorant "Mileniumi" duke ngrënë dhe duke pirë birra aty, as pse dikush diskriminohet dikush punon e dikujt ia mbyll me cenzurë dhe ia dërgon inspektorët me mbyll lokalit në mes të Podujevës, as pse dikush shkon të blejë bukë në Prishtinë e dikush gatuan në shtëpi, pra këto nuk janë probleme tona, janë probleme të njeriut që e ka lapsin në dorë dhe merr vendimin e që nuk është marrë ai vendim, por këtu duhet të punojnë të dielën se nuk di se çka punojnë punëtorët, mund të thoni duhet të punojnë, kurse ata le të mendoj çka të dojnë ose nuk duhet të punojnë, nëse veç dëshiron ta kryesh punën.

Çështja tjetër përse ky dokument i KAB nuk kalon është sepse është në dëm të qytetarëve sepse është bërë vetëm qysh ka dashur Ekzekutivi por edhe siç kanë pasur dëshirë, madje vetëm për dy pikëpyetje të japin përgjigje këtu, 1 votë e ka më shumë prej meje, por as edhe një nuk mund ta jap asnjë drejtor Drejtorie, por vetën insistojnë ashtu, shembull renovimi i shkollave, mirëpo nuk ka shkollë në Komunën e që nuk ka emër, nuk ka rrugë në llap që nuk ka emër, pastaj nuk ka ambulante që nuk e din ku është dhe në cilin fshat gjendet, e tani me pyet drejtorin cila shkollë thotë në fshatin Shtedim se i teket qashtu, por tani kot se nuk ia miratoj sepse nuk i ka paraparë 300,000.00 € apo

500,000.00€, kurse tani drejtori po thotë 20% kemi investuar në Arsim më shumë, 30% në Kulturë më shumë etj etj, kurse asnjë buxhet nuk është bërë, mirëpo nuk ka për të mundur ky Teatër qysh po thotë Kryetari me mbajt shfaqje sepse vetëm për rroga të tyre është paraparë buxhet këtu, pastaj nuk ka për të mundur një mësues në llap me hy në atë kabinetin e famshëm të LVV-së të informatikës, pa keqkuptime por ish këshilltari i Kuvendit tani Deputet i Kuvendit të Kosovës thoshte 500,000.00€ për informatikë, nga 300,000.00€ për atë dhe për këtë dhe propozonte dhe kërkonte t'i japim votën, ndërsa tani më tregoni mua se ku do të ndërtohet kabineti. Kështu që unë kam pritur që sot do të ketë diçka tjetër, por po vazhdon rruga e drejtorit të DPZHE-së, kam pritur që sot ka për të ardhur planifikim specifik për çdo rrugë, për çdo shkollë, për çdo ambulantë dhe të na jepen sqarime që në cilin fshat, kam pritur të na jepen kostot e projekteve, gjatësinë e rrugës, a ka për tu shtruar në zhavorr apo me asfalt dhe mjetet e parapara, prandaj e them se me mua nuk mund të bisedosh ashtu i nderuar drejtor, madje as edhe nga subjekti im politikë po të ishe nuk do të mund të bisedosh në këtë formë, vetëm ashtu mendon, kështu që nëse nuk e ke bërë, merre KAB-in sikur drejtori i DPZHE nën sqetull përgatite dhe sjelle në Kuvend këtu, pyeti drejtorët këtu dhe ti japin specifikat për rrugë, për shkolla, për ambulantë dhe për projekte tjera, merri parametrat dhe paralogarit e renovimeve dhe ndërtimeve, atëherë nuk ka nevojë fare LVV-ja ta votoj sepse ne e vazhdojmë punën vet, por nuk i ke sjellë, ia pafsh hajrin bashkë me të.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, fillimisht për çështje të korrektësisë dua ta potencoj për shkak se u përmend disa herë drejtori z.Pajtim Balaj, drejtori për çështje personale sot nuk është në punë dhe realisht nuk është mirë me lidhë mungesën e tij me çështjen e Rregullores për orarin e punës së bizneseve.

Sa i përket KAB-it, thirrja ka qenë publike për diskutim, fatkeqësisht askush nga ju asamblistë nuk ka marr pjesë në diskutimet publike për këtë dokument, kështu që të gjitha këto sugjerime që i keni sot keni mund me marr pjesë në debat dhe me i dhënë. Sa i përket çështjes së rrugëve është çështje që edhe unë pajtohem me ju, por siç e ceku edhe drejtori i DBF ky është një dokument primar dhe ky dokument do të ndryshoj dhe sigurisht këto specifikime të rrugëve do të bëhen. Çështja tjetër që po dua ta potencoj është edhe çështja e drunjtëve dekorativ, tenderi i drunjtëve dekorativ e dini mirë që është shpall nga qeverisja e kaluar dhe është realizuar gjatë kësaj periudhe kur ne jemi në pushtet, kështu që çmimin nuk e kemi përcaktuar ne e ka përcaktuar krejt dikush tjetër por ne realisht kemi qenë të obliguar që ta implementojmë.

Në përgjithësi ajo që pash nga debatet e juaja është që në njëfarë forme ju gjithmonë keni kriteret e juaja por në përgjithësi jemi të pajtimit që kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është një dokument në rregull dhe unë mendoj që fundja është e drejtë e juaja nëse e votoni apo jo, mirëpo mendoj që ky dokument është prej dokumenteve më të mira që ka qenë ndonjëherë në Kuvendin e kësaj Komune.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, jo për replikë me Nënkryetaren znj.Marigonë Lahu sepse nuk kam dëshirë me ngritë replika, mirëpo nuk e pëlqej mundimin e saj për me dal në foltore dhe ta arsyetosh drejtorin e DBF-së kur ky është prezent këtu sepse nuk mund ta arsyetosh e nderuar.

Është e vërtetë që ka qenë debati publik por nëse LVV-ja dhe Ju si Nënkryetare e Komunës, kryetari i komunës dhe drejtori i DBF mendoni që duhet me ardhur opozita ose një asamblist me i tregu drejtorit në debat publik që duhet të vendoset emri i shkollës, ku do të merrni mjete me i shpenzuar, nuk e din sa ka për të kushtuar rinovimi etj, unë nuk kam çfarë të diskutoj për atë nivel nëse ashtu mendojnë, nëse duhet me i tregu që kur ta bësh një investim çoftë edhe në fshatin tënd në fshatin Gllamnik që boll keq je ankuar për LDK-në që ka pasë 150,000.00€ apo 18,000.00€ kurse tani i keni heq dhe keni planifikuar 30,000.00€ e që as për këto 30,000.00€ ju si Nënkryetare e Komunës nuk e dini se ku do të investohen, nëse po dil këtu në foltore dhe thuaje që në fshatin Gllamnik me 30,000.00€ kanë për tu rregulluar kjo ose ajo rrugë, pra dil këtu publikisht dhe thuaje para kamerave,

shumë konkret tregona se me shumën prej 30,000.00€ në fshatin e juaj Gllamnik cilat rrugë kanë për tu shtruar në 2022, por ju si njeriu i dytë në Komunë kur nuk e dini, nuk bënë të zgjohesh të arsyetosh këso gjërash, duhet të thuash dokumenti nuk është si duhet dhe ne po rrimë qoftë edhe deri në ora 17:00 sepse kemi përgjegjësi publike, kurse ju po përtoni tani sepse keni ardhur në pushtet, ndërsa ne si opozitë jemi që të rregullohet dokumenti dhe do ta miratojmë, madje qoftë e nevojshme deri në ora 18:00 apo 20:00 po rrimë, sepse atje tek qytetarët po thoni ne jemi në shërbim dhe i kemi lodh qytetarët duke i'u thënë për qytetarët, në të mirë të qytetarëve e gjëra të tilla. Pra deri në ora 20:00 po presim vetëm merre letrën, shko rregulloje dhe jepu përgjigje atyre qytetarëve, unë e di përgjigjen pa dalë pa dal ju fare këtu në foltore. Prandaj nuk qëndron ajo që ju e potencuat se keni mund të jepni sugjerime dhe vërejtje në debat publik, vërejtjet mund të japim nëse do të ishim kundër investimeve dhe të thonim përse këtu 500,000.00€ e aty 300,000.00€ shembull, pse në fshatin Gllamnik 30,000.00€ kurse në 5 fshatra tjera 10,000.00€ ose anasjelltas, por ne nuk po lidhemi për shifrat investuese por nuk po e dimë as ne por as ju si Nënkryetare, janë paraparë 500,000.00€ për lidhjen e nyjës së rrugës me magjistralen Podujevë-Prishtinë e që as ju e as Kryetari juaj nuk e dini që institucioni s'pari duhet të parasheh mjete për shpronësim sepse keni hyrë oborreve të njerëzve të kurse prona private është e pa prekshme, prandaj ne nuk kemi kohë të debatojmë për këto gjëra por sido që të jetë unë po them që as drejtori në fshatin e tij as ju si Nënkryetare as Kryetari z.Shpejtim Bulliqi në fshatin Lluga që e kishte paraparë me përjashtim të një shkolle për tu ndërtuar e që as për atë nuk ka dhënë emër, por që për atë duhet me marr leje nga këtu si Kuvend, e jo me shku në zyre dhe me u ulë e me i vendos gjërat në letër dhe pastaj me debatuar e që jam i gatshëm për debat deri në pafundësi, me arsyetim dhe argumente e vazhdojmë debatin replikat dhe kundër replikat qysh ta keni disponimin ju, por me dokumente duhet të barazoheni me mua vetëm në këtë formë, ndërsa për performancë është çështje tjetër ato janë gjëra tjera.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, i nderuari z.Rafet Llapashtica para se të kemi një funksion publik të gjithë ne jemi qytetarë dhe realisht secili nga ne duhet të japë kontributin e tij në debate. Sa i përket fshatit Gllamnik që ju e cekët, asnjëri nga ju nuk mund të flisni për fshatin Gllamnik më shumë se sa unë. Të gjitha rrugët e fshatit Gllamnik do të specifikohen, andaj unë s'do të lëshohem më shumë në debat këtu sepse mund të diskutojmë për çështje përmbajtësore të Kornizës Afatmesme Buxhetore, e jo diskutime të tilla.

z.Rafet Llapashtica, përgjigje Nënkryetares së Komunës, theksoi, zonja Nënkryetare, specifikojeni rrugën, e keni votën.

z.Ragip Fetahu, theksoi, mua më vjen mirë që kolegët e mi kanë fjalë të mira, madje edhe aktrojnë në foltore. Mendoj se nuk është detyrë e jona me bë ndarje në zona të tilla, vërejtje të tilla kam pas edhe unë lidhur me specifikimin dhe i kam pyetur drejtorët e Drejtorive përkatëse pse është kjo mungesë e specifikimit të projekteve, drejtori i DBF-së z.Fatlum Osmani është përgjigjur se janë dy probleme në DPUMM, problemi i parë ka të bëjë me mungesën e profesionistëve, që nuk ka numër të mjaftueshëm të arkitektëve dhe të inxhinierëve sepse këta janë duke u marrë me realizimin e projekteve që janë në vazhdim, madje edhe të viteve të kaluara, kurse problemi tjetër ka të bëjë me emërtimin e rrugëve dhe rugicave të cilat nuk janë të asfaltuara, shumica prej tyre nuk janë emërtuar dhe këtë temë e shoh si çështje kritike. Në këtë kornizë buxhetore do të doja të jetë e përfshirë ajo që profesori amerikan Richard Florid në vetit e tij të komunitetit dhe kreativitetit i quan parqe feknologjike. Janë parqe të cilat i nxisin të rinjtë për idetë e tyre kreative, por ne nuk jetojmë në Londër apo Nju York, ne jetojmë në Prishtinë dhe Podujevë dhe e dimë gjendjen dhe buxhetet tona sa i kemi si nivel lokal.

Projektet të cilat janë përshkruar në këtë kornizë, përfshihet infrastruktura në qendër dhe në periferi, që dallon nga kornizat tjera buxhetore. Tema profesional nënkupton krijimin e një shteti policentrik.

Ngritja e nivelit të arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe rinisë, pikë për të cilën unë disa herë e kam ngritur zërin edhe nga shoqëria civile, që të ketë rritje të buxhetit për këto pika e për këtë çështje e ka arritur qëllimin drejtori në fjalë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, një sqarim kam për parafolësin kolegj z.Ragip Fetahu, paragjykimi im i kalon barrierat e një anëtarit të një partie politike shqiptare, këtë ngulite në kokë kur të debatosh me mua sepse nuk më intereson se çka mendon subjekti. Ju deklaroj për rrugët dhe rrugicat, në foltore po citoni citate të Vaslav Havelit dhe po deklaroj se ato janë rrugica pa emër. Rrugë dhe rrugicë, këtë toponim duhet ta dish nëse nuk dini me bë dallimin mes rrugës dhe rrugicës mund t'ju sqaroj por besoj se këtë e dini. Mos u deklaroni se janë disa rrugica që s'janë emërtuar, ose ke ardhë këtu për me ia bë votën Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi dhe drejtorit të DBF dhe nuk e ke lexuar dokumentin, e që kjo është çështje tjetër. Ti (i drejtohet parafolësit) s'je marrë me dokumentin fare hiç, unë jam marrë specifikisht me këtë çështje, në dokument nuk ka toponim të emrit rrugicë ashtu siç deklaruar ju, tani ato rrugicat ndash mund t'i quajmë Ragip Fetahu ndash Rafet Llapashtica, apo si të dëshironi, mirëpo ne këtu nuk kemi të bëjmë me emra të rrugicave sepse ka pas tendencë në mënyrë të ndryshme që të emërtohen këto rrugë qofshin në emra të baballarëve apo tezakëve e që në disa raste këto propozime edhe kanë depërtuar. Për mua emërtimi rrugë dhe rrugicë kanë dallime të mëdha sepse në dokument nuk kërkohet asfaltimi i disa rrugicave në fshatin tuaj shembull, por është asfaltimi i disa rrugëve. Këtë sqarim ua ka bërë drejtori i juaj dhe i keni besuar, keni thënë se ish drejtori i kaluar është deklaruar se nuk ka emërtime të rrugëve sepse këto kalojnë në mënyrë të përgjithshme, prandaj mendoj se është mirë të dilni dhe të deklarojeni se kjo çështje ka qenë keq në të kaluarën kur ka qeverisur LDK-ja, unë kam votuar kundër edhe pse ka qenë faza e fundit e emërtimit të rrugëve, por mos u mundoni ta arsyetoni dokumentin sepse arsyetimi i takon drejtorit e jo juve sepse ju dhe subjekti juaj nuk keni qenë pjesë e hartimit të këtij dokumenti.

Sa i përket mungesës së profesionistëve në DPUMM, ky nuk është problem i opozitës e aq më pak i PDK-së, sepse ne nuk mund t'ju sjellim kuadro. Si do ta arsyetoni dokumentin në mungesë të profesionistëve, a do e merrni "tupanin" e do të dilni në qendër dhe t'i informoni njerëzit apo si.

Prandaj kur dëshironi replikë me mua, replika duhet të jetë konkrete sepse kur e ke replikën mirë unë di të them mirë e ki mirë, madje dhe kërkoj falje por në këtë rast jeni gabim ju.

Gjithë dokumentin ju mund ta arsyetoni por kur atë dokument e sjellë në Kuvend drejtori unë votoj kundër sepse atë dokument duhet ta arsyetoj ai e jo ju të tjerët apo unë sepse nuk jemi kompetent për ta arsyetuar atë dokument, e që këtë dokument nuk e ka rregulluar dhe nuk e ka sjellë në Kuvend asnjëri prej subjekteve politike qoftë LVV, PDK, LDK, andaj ju jeni për të dhënë vërejtje konkrete sepse ekzistojnë emërtimet e rrugëve, shkollave, çerdheve etj. Nesër doni që të kërkoni votë dhe nëse dikush në fshatin tuaj ju pyet për projektin në fjalë deri në vitin 2024 dhe nuk keni përgjigje me dhënë, jo për fajin dhe angazhimin e juaj politik por për shkak të amullisë e që është dashur ne t'i tregojmë drejtorit të DBF dhe Kryetarit se si janë emërtuar rrugët në fshat.

Në DPUMM janë 700 ankesa që kanë të bëjnë me emërtimin e rrugëve.

z.Ragip Fetahu, përgjigje parafolësit, theksoi, së pari unë e di dallimin në mes të rrugës dhe rrugicës sepse i kam 20 vite edukim, kurse sa i përket literaturës së Vaslav Havelit, për këtë literaturë nuk kam njohuri, çdo libër që kam mundësi e lexoj sepse është përfitim i njohurive e sidomos ato në aspektin profesional. Çështjet të cilat unë i cekë dhe i potencoj janë mendime të mia personale dhe kam të drejtë ta mbroj drejtorin në fjalë kur dihet se drejtorin z.Fatlum Osmani 7 ditë të javës mund ta gjeni në zyrë të punës.

Për rrugët që i përmendi kolegu z.Mehmet Gashi, sa e di unë janë të përfshira në KAB.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sa i përket këtij propozimi duhet të plotësohet afati ligjor në Ministrinë e Financave, kurse sa i përket përshkrimit të projekteve dhe ndarjes së mjeteve buxhetore u cekë edhe nga parafolësit e që është për keqardhje. Qytetarët kanë të drejtë që të jenë të informuar për investimet kapitale që do të bëhen në vendbanimet e tyre. Është interesante se kolegja znj.Doruntina Hasani kur qeveriste LDK-ja, ka deklaruar se buxheti po shkon për ndërtimin e rrugëve konkretisht për asfaltim dhe kanalizim, kurse sot është interesante se e njëjta deklarohet se kërkesat e qytetarëve janë për këto investime, këto janë standarde të dyfishta e që lexohet se nuk ka pasur njohuri për kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Te Drejtoria e Inspeksionit pika tre detyrat e DI, janë që të ndalojë ndërtimin e objekteve të pa ligjshme të vendbanimeve dhe ndërtesave, objekteve të Komunës si dhe të organizojë lirimimin e tyre. Pyetja është për drejtorin e DI, a do të merrni masa dhe kur do të filloni lirimimin e hapësirave të uzurpuar që në mesin e tyre ke një pronë të uzurpuar edhe nga Kryetari z.Shpejtim Bulliqi, që është nxjerrë vendim administrativ në këtë drejtim për pronën e Kryetarit dhe a është marrë ndonjë veprim.

Sa i përket DPUMM për atë që ceku parafolësi është shqetësuese fakti se si janë përshkruar projektet për asfaltimin e rrugëve kur 95% e tyre nuk janë emërtuar. Sa i përket fshatit Orllan dhe fshatrave përreth ne të gjithë e dimë se cilët janë ato fshatra përreth. Ndërsa për DPZHE nuk dua të lëshohem më tutje sepse mungon drejtori e që po të ishte këtu vetëm ndonjë skandal do e bënte. Në DBPZHR kemi të bëjmë me subvencione për perimekulturë dhe subvencione me mekanizëm bujqësor, do të ishte mirë për ne dhe qytetarët por edhe për mediat që t'na jepen sqarime se çka bëhet fjalë për këtë subvencion perimekulturë.

Po ashtu kam pyetja për drejtorin e Drejtorisë së administratës i cili edhe është aksionar i NPL - Stacioni i Autobusëve Podujevë, që ka të bëjë me këtë Ndërmarrje, mirëpo meqë drejtori nuk është prezent këtu sikurse edhe drejtori i DSHMS për të cilin kisha pyetje lidhur me ndërtimin e QMF-III në Podujevë, a ka planifikuar se sa do të jetë numri i personelit mjekësor në këtë qendër. Gjithashtu në planifikimin buxhetor për 2021-2022 nuk pash se ka të planifikuar ndërtimin e çerdheve, edhe pse në fushatë elektorale ka qenë premtim i juaji.

z.Haki Rudari, theksoi, me vëmendje i dëgjova të gjithë kolegët rreth shtjellimeve të paraqitjeve të tyre por në të njëjtën kohë kam një pyetje për kolegët që janë këtu prezent, se për 20 vite a ka qeverisur LDK-ja, apo një parti tjetër. E kam Kornizën Afatmesme Buxhetore që ka përgatitur LDK-ja të viteve të mëparshme dhe i'u drejtohem kolegëve nga LDK-ja, këto kategori që ju po i citoni këtu kanë qenë për 18 vite.

z.Hasan Ajeti, nga vendi duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, tani ju jeni në pushtet, ju udhëhiqni me Ekzekutivin.

z.Haki Rudari, vazhdoi, kjo vërejtje e LDK-së është e pa bazë dhe si e tillë bie poshtë sepse të gjitha ato vërejtje që ju po i citoni janë në këtë KAB. Tani ne në parim e kemi marrë këtë si vërejtje dhe e kemi biseduar me drejtorin e DBF-së që në të ardhmen duhet të specifikohet ky KAB sepse në këto 18 vite LDK-ja i ka bërë këto gabime. Këtu kemi një rritje të mjeteve buxhetore në arsim dhe kulturë, në arsim janë 684,000.00€ që është një shumë e mirë por jo e mjaftueshme, unë kam një përvojë 30 vjeçare në arsim dhe e di se gjendja nuk është e mirë andaj kjo shumë buxhetore nuk i mbulon të gjitha kërkesat në sektorin e arsimit. Në kulturë kemi një rritje të mjeteve buxhetore në vlerë 350,000.00€, pastaj në krahasim me KAB-in e mëparshme në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë ka qenë një shumë e mjeteve shumë e vogël, prandaj unë i referohem shumëve e jo retorikeve sa për sy e faqe.

Në parim jam për që të bëhet një shpërndarje e projekteve sepse për 4 vite si shef i Grupit të këshilltarëve të LVV-së kur LDK udhëhiqte Ekzekutivin kam bërë vërejtje se shpërndarja e

projekteve duhet të bëhet në bazë të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve sepse qytetarët kontribuojnë në buxhetin e Komunës përmes pagesës së taksave.

Një çështje tjetër që dua ta ngrisë është ajo e vizitave në terren që ndërlidhin shumë çështje qofshin ato me ambientin, gurëthyesit, dëmtuesit e pyjeve, apo infrastrukturës, andaj secila Drejtori përkatëse i ka ekipet e saj dhe duhet të veprojnë sepse kemi kërkesa dhe ankesa nga ana e qytetarëve që ndoshta në një seancë të ardhme të gjitha këto do t'i paraqes.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sa i përket asaj që e ndërpreva parafolësin gjatë diskutimit kërkoj falje, por e bëra sepse nuk është etike që këtyre 20 viteve që ju po i referoheni, ne kemi qeverisur me votën e lirë të qytetarëve, ndërsa për atë që kemi qeverisur keq ne (siç po thuhet) ja ku jeni ju tani, andaj mos nxirrni hipoteza të tilla sepse sot ish drejtori i DKA-së nga radhët e LDK-së është Kryetar i Komunës dhe i takon subjektit tuaj, dhe ish drejtorin e DBPZHR nga radhët e LDK-së, tani e ke drejtor të DKA-së po ashtu nga subjekti i juaj LVV-së, si dhe keni shumë kuadro që i keni marrë prej LDK-së, prandaj për të gjithë këta nuk mund të thuash se s'kanë qenë të mirë andaj këto nuk mund t'i nxjerrësh si argumente të vitit 2016 apo 2018.

Sa i përket "qeverisjes së keqe" nga ana e LDK-së, tani keni fituar ju LVV-ja dhe vazhdojeni punën sepse keni ardhë për ndryshime dhe keni plotësisht të drejtë të kërkonit sqarimin e këtyre pikave të parashikuar në këtë planifikim.

z.Haki Rudari, theksoi, e pranoj kërkimin faljen e kolegut, faleminderit, por unë isha duke thënë atë që ju keni gabuar për 18 vite dhe ai gabim duhet të pranohet sepse as tani nuk them se puna është mirë. Për 18 vite të bëhet i njëjti gabim, realisht duhet pritur pak sepse nuk mundesh me ditë se ku po gaboni, unë mendoj se në të ardhmen duhet të bëhet evidentimi i problemeve në lagje, shkollat dhe fshatra të e ndryshëm.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, mua më vjen mirë që LVV-ja ka arritur ta rrisë këtë nivel që e cekët për detajizimin e projekteve dhe të jeni të bindur që të parët këtë gjë që e kemi kërkuar jemi ne ashtu siç e ceku kolegu z.Ragip Fetahu, dhe se kjo çështje do të arrihet brenda një periudhe shumë të shkurtër. Nuk mund të realizohen të gjitha këto projekte për këtë periudhë të shkurtër kohore andaj mos përdorni standarde të dyfishta sepse më herët s'keni kërkuar kurrë specifikim të projekteve, atëherë kur ju keni udhëhequr me Ekzekutivin, përse tani e kërkonit këtë specifikim, çfarë ka ndodhur te ju.

z.Agron Hyseni, theksoi, sa i përket standardeve të dyfishta unë kam një pyetje për projektet prioritare për vitin 2023, në renditjen si pika 4, projekti nr.4, është asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Orllan dhe fshatrat përreth, ku gjithsej janë 13 fshatra. Shuma 150,000.00€, nëse mund ta quani specifikim në këto 13 fshatra për investime relative, atëherë realisht ky është ndryshim.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, në mënyrë përmbledhëse do të mundohem t'ju japë disa sqarime lidhur me specifikimet që i cekët te investimet në shumë kode buxhetore të cilat janë të paraqitura në KAB. Për shumë kode buxhetore kur është fjala te DPUMM janë të specifikuara asfaltimi i rrugëve në disa fshatra ose ndërtimi i rrugëve me zhavorr, deri më tani është intervenuar në 100 rrugë me zhavorr, ndoshta vitin tjetër do të intervenohet me zhavorr në 150 rrugë, në këto rrugë intervenohet varësisht nevojave.

Sa i përket specifikimit për investime në shkolla që ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës shkollore do të ketë ndërhyrje po thuajse në të gjitha shkollat, varësisht nevojave në dyshe, dritare dhe dritare, mirëpo është shumë e rëndësishme pse do të ndërhyhet në çdo institucion arsimor, këto ndërhyrje do të bëhen për arsye se në buxhetin për arsimi ka 6.5% më shumë investime se sa në vitin 2021. Arsyeja e këtyre ndërhyrjeve nuk është se ka rritje 6.5% më shumë në buxhetin e Komunës së Podujevës por për arsye se sektorit të arsimit i është dhënë prioritet. Ne kemi këtë buxhet i cili është në bazë të limiteve buxhetore të Ministrisë së Financave, mirëpo në kuadër të këtij prioriteti ne kemi

vendosur prioritetet tona. Në shumë raste nuk është i mundur specifikimi, andaj ne sot jemi këtu si subjekt politik që qeveris dhe jo vetëm në të kaluarën që ka qeverisur LDK-ja, mirëpo ne edhe sot qeverisim në shumë Komuna. Pjesa dërmuese e projekteve kur bëhet fjalë për projekte jo madhore që nuk kanë shuma të mëdha qoftë ajo shumë 2 milion euro shembull, se bëhet fjalë për shuma prej 30,000.000€ - 40,000.00€ apo 60,000.00€, për asfaltimin e disa rrugëve në disa fshatra, këtu nuk bëhet fjalë për specifikim për metër të asfaltit për këtë çështje, çështje kjo e cila u ngritë nga një numër i madh i asamblistëve e që faktikisht kjo përgjigje vlen për të gjithë.

Sa i përket çështjes të cilën e potencoj asamblisti z.Bashkim Sylja se kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore është vazhdim i buxhetit, kjo nuk është e vërtetë edhe pse vlera e buxheti është përafërsisht e njëjtë dhe këtu mund të keni lajthitje se në vitin 2021, është klauzola e investimeve në shumë 1,125,000.00€ që nuk është buxhet i rregullt, është kredi që ka të bëjë me ndërtimin e korridorit të famshëm prej 5,000,000.00€ investim. Sa i përket sektorit të arsimit ka rritje prej 6.64% më shumë, pastaj 2.94% rritje më shumë ka në sektorin e ekonomisë, 56.5% rritje ka në sektorin e kulturës, do të thotë se për herë të parë në buxhetin e Komunës së Podujevës përmendet sektori i kulturës, ndokush do të thoshte përse 100,000.00€, janë sepse në partneritet me Ministrinë e Kulturës rinisë dhe Sportit Komuna e Podujevës do të participoj me pjesën e cekur buxhetore prej 100,000.00€, kurse pjesa tjetër do të financohet nga Ministria e cekur, fjala është për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës që do të bëhet në partneritet me Ministrinë e Kulturës. E mira është që edhe niveli qendrorë po e përmend kulturën, ndoshta që në pushtet kanë ardhur disa njerëz pak më të kulturuar se që kanë qenë.

Në shëndetësi nuk ka ngritje të madhe për arsye se Qarkorja Buxhetore, granti specifik për shëndetësi ofron mjete financiare të mjaftueshme për financimin në nivelin primar shëndetësor në Komunën e Podujevës, pra janë 3,073,000.00€ në grantin specifik, andaj niveli primar shëndetësor nuk është shumë i kushtueshëm. Te kategoria mallra dhe shërbime në KAB për çdo gjë specifikohen mallrat dhe shërbimet, LDK-ja kur e ka aprovuar buxhetin ka ndarë 2,360,000.€ në kategorinë mallra dhe shërbime, dhe nuk i ka specifikuar se ku do të ndahen këto mjete, qoftë për blerjen e derivateve, drurëve, dezinfektimit, andaj buxheti do të specifikohet. Në KAB nuk është praktikë që të specifikohet buxheti, kategoria e mallrave dhe shërbimeve specifikohen, tani kemi një rritje në kategorinë e mallrave në një shumë jo aq të madhe por që do të mbulohen nevojat duke marrë parasysh ekonomizimin më të mirë që nuk do të shpenzohen për dezinfektim 500,000.00€. Asamblisti i nderuar z.Adnan Zymeri fol për disa çështje dhe bën sulme personale dhe flet për kompetencë thuajse ka marrë çmimin Nobel për ekonomi, a është student i skriptave, fol për kompetencë dhe për KAB-in se është marrë model nga Komuna e Prishtinës, si dhe për kompetencën time, nuk është e rëndësishme se kush jam unë. Kam punuar në kontabilitet, kam qenë pjesë e përpilimit të KAB-it në Komunën e Prishtinës sepse aty kam punuar 6 vite në Drejtorinë e Arsimit që ka një buxhet 31,000,000.00€ që i bie afërsisht një buxhet prej 50% më shumë se i Komunës së Podujevës, KAB funksionon në bazë të disa modeleve e tani ju flisni për kompetencë thuajse 20 vite ne nuk ua kemi dhënë kompetencën ish drejtorëve që kanë qenë dhe këtyre aktual.

Komuna e Podujevës e ka një fat të mirë se për herë të parë drejtor i DPUMM-së është një arkitekt që ka punuar projekte me renome në Kosovë, do të thotë nuk ka pasë asnjëherë drejtor të urbanizimit një arkitekt, pra është i pakrahasueshëm niveli dhe nuk dua të hyjmë në çështje, andaj është e parëndësishme ajo që i referoheni si referencë dhe kompetencë, sepse atë e keni mësuar ju me akademikët e juaj, ndryshe qëndron niveli i disave nga partia juaj e që ish Kryeministri Avdullah Hoti më shkruante referenca që të bëhem asistent e që nuk kish mundësi sepse edhe aty i keni pasë të kaptë në të gjitha anët dhe s'ka pasë mundësi askush të merr erë aty përveç atyre kllapave të LDK-së që kanë qenë dhe që vazhdoni me qenë. Ju nuk mund të flisni për kompetencë dhe moralizim në

raport me mua sepse bagazhi është i ndryshëm, ju keni një kompetencë dhe mund të flisni sepse keni një kompani “Toifor” dhe mund të keni aplikuar për ndonjë tender në Komunën e Podujevës, asnjëherë nuk jam njohur me ju apo me ndonjë familjar tuajin, fillimisht kërkoj falje që po e përmend këtu sepse ndoshta nuk është vendi që ta përmend një gjë të tillë këtu, por rastësisht jemi takuar me Bedri Maçastenen i cili njihet personalisht me Enver Zymerin, axhën e juaj, dhe me një shaka të vogël xhaxhait tuaj i thotë Bedriu a po ju merr Agimi, ai ia kthen, në krejt dynjanë nga 5% është, prandaj për moral ti (i drejtohet Adnan Zymerit) më vie keq por nuk mund të më flasësh sepse nga 5% ju se konsideroni asgjë, atë e ka thënë ai dhe atë para qytetit të Podujevës, dëshmitarë e kam Bedri Maçastenen, që është edhe vet ai dëshmitar, prandaj edhe njëherë jua përsërisë që për moral mos gabo të flasësh asgjë.

Si do që të jetë Kryetari dhe unë ju kemi bërë ftesë të gjitha Grupeve të asamblistëve që të marrin pjesë në këtë buxhet sepse ky buxhet nuk është i kësaj qeverisje ta zëmë, sepse në muajin tetor janë zgjedhjet, rezultati dihet përafërsisht, por si do që të jetë jashtë rezultatit në trashëgojmë një buxhet të realizuar nga ana juaj. Ne mund të vazhdojmë dhe mund të mos jem më drejtor i DBF por jemi qytetarë të Komunës së Podujevës dhe buxheti është i të gjithëve. Për kontributin dhe përpilimin e buxhetit për çdo propozim, sepse këtu nuk po flasim për dije dhe kompetencë, e që ne mund të jemi shumë më kompetent se sa ata që flasin për kompetencë, ne jemi të gatshëm t’i marrim propozimet, mund të jetë një propozim shumë më i mirë që i prinë procesit të aprovimit të buxhetit që do të miratohet në muajin shtator, në qoftë se e voton asambleja komunale sepse ne e propozojmë buxhetin asambleja e miraton, mirëpo jemi të gatshëm për bashkëpunim gjatë fazës së përpilimit, ndërsa të mos jepet kontribut këtu dhe pastaj të ketë vetëm vërejtje dhe kritikë apo mos të miratohet buxheti nuk më duket në rregull, mirëpo ne i nënshtrohemi demokracisë e në këtë rast demokracia është asambleja komunale, e që do të vjen asambleja e re komunale e mund të ndodhë ajo që ka ndodhë në nivel qendror që dikush i zë dy rreshta e dikush të gjithë sallën.

z.Adnan Zymeri, theksoi, i nderuar drejtor i DBF, më vie shumë ke që ke dalë nga vetvetja. **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ju lutem që ta zbatoni Rregulloren e Punës së Kuvendit, mund të jepni argumentet e juaj por jo të përdorni fjalor banal apo ku ta dijë unë.

z.Adnan Zymeri, vazhdoi, ne kemi ardhë për bisedime konkrete që ndërlidhen me punën e secilit nga ne këtu. Drejtori deklarohet se unë po flasë për atë personalisht, por nuk është ashtu, unë po flasë për drejtorin e DBF-së, ashtu siç kam thënë edhe herën e kaluar. E di që ju e keni një përshtypje se duhet imponuar mendimin njerëzve dhe që të gjithë njerëzit të mendojnë njësoj si ju për secilin dokument dhe secilën punë që e bëni në secilin pozicion që e keni, por ne nuk jetojmë në një sistem komunist, jetojmë në një sistem demokratik dhe kemi të drejtë të shprehemi ashtu siç mendojmë. Unë asnjëherë s’dëshiroj të ndalem në gjëra personale kur ka argumente profesionale, kur nuk ke argumente për punën që bëni, njerëzit e ulët kthehen dhe diskutojnë gjëra që i kanë diskutuar në parqe dhe në rrugë.

z.Fatlum Osmani, drejtori i DBF, i drejtohet parafolësit, 5% që ka thënë xhaxhai juaj.

z.Adnan Zymeri, theksoi, në rregull është, unë s’ndalem këtu sepse aspekti njerëzor është vlerësim i thjeshtë që e din dikush që e ka të përfunduar vetëm shkollën fillore. Më herët drejtori i DBF atë që e përgjithësoj duke thënë se të gjithë ne që kemi qenë në pushtet për 20 vite deklaroi se kemi qenë njerëz të pa kulturuar kurse tani kanë ardhë në pushtet njerëz të kulturuar, nuk e di se me çfarë lloj instrumenti e matni ju kulturën, nëse është kulturë e atyre njerëzve që kanë gjuajtur dhe kanë thyer atëherë në rregull e konstatojmë ashtu. Të lutem drejtor që në të ardhmen gjatë diskutimeve rreth punës tuaj, diskutimet mos i merr me shqetësim por si diskutime normale, diskutojmë i ofrojmë argumentet në tavolinë vendosim, dhe jemi në rregull.

z.Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit –DPUMM, theksoi, këtu u cekën disa kritika rreth specifikimit të rrugëve të cilat për mua nuk janë aq shqetësuese që mos të miratohet ky buxhet, e gjithë kjo ka ardhë si shkak se kemi gjet një buxhet të pa specifikuar. Planin e prokurimit që fillon më datë 01 janar 2022, për ta realizuar duhet kohë rreth 6 muaj derisa të ndërmerren veprimet konkrete. Mungesa e specifikimit është për shkak të mungesës së kohës dhe stafit për shkak se ne si DPUMM nuk merremi vetëm me trajtimin e rrugëve por edhe me trajtimin e lëndëve të ndryshme. Kërkesa për specifikim nuk është diçka jashtë normales por është diçka që duhet të ndodh, mirëpo që duhet kohë. Deri në fund të vitit kjo çështje do të vendoset në binarë dhe prej vitit të ardhshëm gjithçka do të shkojë në bazë të specifikimit me kohë sipas afateve të caktuara, kjo është arsyeja pse s’kemi arritur ta bëjmë specifikimin. Kërkesa juaj është legjitime të cilën e përkrahi edhe unë sepse mund të ketë ndonjë projekt më funksional, mirëpo arsyetimi jonë është më i qëndrueshëm se sa kërkesat e juaja.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, atëherë unë e hedh në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 13 vota janë PËR, 20 vota janë KUNDËR, dhe 1 votë e PËRMBAJTUR, nuk miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2022/2024 e Komunës së Podujevës.

Kryesues i Kuvendit, nëse jeni të pajtimit mund të shkojmë në pauzë për 1 orë.

Nuk pati kundërshtime për pauzë, Kuvendi shkon në pauzë deri në ora 13:30.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 13:45, duke konstatuar kuorumin ku prezent ishin 32 këshilltarë të Kuvendit (lista e pjesëmarrjes)

z.Ragip Fetahu, theksoi, kam një vërejtje për ju zotëri Kryesues, ju lutem që gjatë seancave të mbahet pak disiplinë dhe rend në këtë Kuvend. Ta kemi parasysh faktin që jemi para qytetarëve dhe e plasojmë një kulturë të përgjithshme, mbajtja e rendit dhe e qetësisë në këtë Kuvend ju takon juve në bazë të Rregullores së punës të kuvendit dhe mos të na ndodh që në të ardhmen të ndërpriten diskutimet, debatet e këshilltarëve komunal, në mungesë të disiplinës së kolegëve tonë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj këshilltarin parafolës për kujdesin dhe përkrahjen. Besoj që ë gjithë e kemi para vetës Rregulloren e Punës së Kuvendit, andaj në bazë të thirrjes së parafolësit, kërkoj nga të gjithë anëtarët të Kuvendit që të respektohet Rregullorja në fjalë. Vazhdojmë me punë sipas rendit të ditës.

4. Propozim Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës

“Avdush Hasani”

- Raporti nga diskutimi / debati publik

znj.Elhame Kutllovci, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, siç e dini diskutimi publik për Rregulloren e Këshillit Drejtues të Teatrit “Avdush Hasani”, ka përfunduar dhe lidhur me këtë çështje jeni informuar në bazë të raportit që keni marrë, më datë 10 mars 2021 është mbajtur diskutimi publik me qytetarë, në këtë takim është diskutuar për rëndësinë e kësaj rregulloreje e cila i referohet punës së Këshillit Drejtues të Teatrit “Avdush Hasani”. Vërejtjet dhe sugjerimet nga takimi me qytetarë nuk

kishte, për vet faktin që kjo rregullore është bazuar në Ligjin për teatrot dhe në Statusin e Teatrit “Avdush Hasani”, por gjatë kohës sa ishte i hapur diskutimi publik Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit e ka parë të nevojshme plotësim ndryshimin e nenit 7 të kësaj propozim rregulloreje, e që plotësim ndryshimi është si në vijim: kompensimi për anëtarët e Këshillit për pjesëmarrje në takime bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe atë jo më shumë se një mbledhje në muaj gjatë vitit fiskal. Plotësim ndryshimin e këtij neni e kemi parë të nevojshëm për shkak se duhet të përcaktohet edhe numri i mbledhjeve për gjatë një viti.

z.Hasan Ajeti, theksoi, gjykoj se propozim Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit “Avdush Hasani”, është në harmoni dhe pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, andaj Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështet këtë propozim Rregullore.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, e mbështet propozim rregulloren sipas kësaj pike të rendit të ditës.

z.Fatmir Rudari, theksoi, po ashtu edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, e mbështet propozim rregullore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, urdhëroni nëse dëshiron ndokush fjalën, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 32 vota PËR, miratohet propozim Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani” sipas materialit përkatës të dërguar.

5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, para vetës keni propozim vendimin për ngritjen e komisionit përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativ arsimore në Komunën e Podujevës. Ky propozim vendim bazohet në Udhëzimin Administrativ të fundit të Ministrisë së Arsimit të nxjerrë më datë 24.12.2020 që parashihet ngritja e një komisioni të tillë, andaj nga ana e juaj kërkojmë ta përkrahni këtë propozim.

z.Hasan Ajeti, theksoi, qëndrimi jonë i Grupit të këshilltarëve të LDK-së dihet sa i përket konkursit të fundit duke ditur se Ekzekutivi ka pas hapësira ligjore duke iu referuar Udhëzimit Administrativ të cekur nga drejtori paraprakisht, andaj si të tillë ne nuk e mbështetim ngritjen e komisionit duke ditur se këta drejtor kanë mund të zgjedhën në pajtim me atë Udhëzim Administrativ.

Pasi që është hera e dytë që është shpallur konkursi ne gjykojmë se ky vendim është puro politik dhe si të tillë nuk e mbështetim.

z.Bahri Blakçori, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, kur dihet se muaji tetor është afër dhe në atë muaj është caktuar data e mbajtjes së zgjedhjeve lokale, dua të di se a është e lejuar që DKA në 6 mujorin e fundit të merr vendime për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve arsimore, lidhur me këtë çështje a mund të na jepni sqarime.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, nuk ka ndonjë dispozitë ligjore që e penalizon një gjë të tillë për çka parashtroj pyetje parafolësi z.Pajtim Hodolli.

Qëllimi i ngritjes së këtij komisioni pikërisht është që mos ketë ushtrues detyre të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, këtu nuk ka të bëjë asgjë politika, përkundrazi planifikojmë që më së largu deri më datë 15.08.2021 të përfundojnë këto pozita të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për mandat 4 vjeçar me mundësi vazhdimi edhe për një mandat ashtu siç është përcaktuar në Udhëzimin përkatës Administrativ, konkretisht në mënyrë që këto pozita mos të mbesin ashtu siç kanë mbetur deri më tani.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas propozim vendimit të dërguar me materialin e kësaj pike të rendit të ditës për këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se me 15 vota PËR, 10 vota KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur miratohet propozim vendimi për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës.

6. Informatë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, rreth procesit të Hartës Zonale të Komunës

z.Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - DPUMM, duke përshëndetur të pranishmit e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, sot para jush paraqes informatë rreth procesit të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës. Plani Hapësinor i Kosovës dhe Harta Zonale e Kosovës janë dokumentet kryesore të sektorit të planifikimit hapësinor që rrjedhin nga Ligji për planifikim hapësinor.

Me ndryshimin e ligjit në fjalë në vitin 2013, Harta Zonale si dokument bëhet pjesë e sistemit të planifikimit hapësinor ka qenë në dy nivelet e qeverisjes, qëllimi kryesor i hartimit dhe hyrjes në fuqi të Hartës Zonale të Komunës është koordinimi i zhvillimit hapësinor në gjithë territorin dhe i ofron qeverisjes lokale një instrument për kontroll të zhvillimit. Harta Zonale është dokument multisektorial me karakter rregullues për mes së cilës definohen ndarjet e territorit të Komunës së Podujevës në zona të tilla si hapësira të lira, banimi, industrisë, bujqësisë, aktivitet ekonomik, ku për secilën zonë caktohen shfrytëzimet e lejuara dhe ato të ndaluara, kushtet e zhvilluara si dhe ato të ndërtimit dhe masat e veprimit për periudhën kohore së paku tetë (8) vjeçare. Pikënisje për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës është Plani Zhvillimor Komunal - PZHK 2016-2025 i cili ka filluar të hartohet në vitin 2009, në këtë rast kemi të bëjmë me një diskrepancë prej shtatë (7) vitesh, fakt i cili nuk është marrë në konsideratë nga institucionet më të larta në nivel qendror. Vizioni për zhvillimin hapësinor të Komunës së Podujevës sipas PZHK-së reflekton për aspiratat e zhvillimit social ekonomik, mjedisor, infrastrukturor dhe të administratës, duke synuar në përmirësimin e gjendjes socio - ekonomike përmes krijimit të mundësive të punësimit dhe uljen e varfërisë.

Në muajin dhjetor 2020 kam marrë detyrën drejtorit i DPUMM dhe posa kam marrë detyrën e kam gjetur projekt Hartën Zonale me pëlqim nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, si dhe një numër të madh të kërkesave të parashtruara përgjatë hartimit të këtij Hartës Zonale të Komunës së Podujevës. Gjatë analizës së bërë dhe kërkesave të ndryshme të qytetarëve, kushtet ndërtimore të të gjitha kategorive të objekteve, ne si DPUMM kemi vërejtur që në draft dokumentin e Hartës Zonale

të Komunës ka mundësi për trajtimin e tyre. Sipas Informacioneve nga ekipi punues i Komunës së Podujevës, nga GIZ-i gjerman dhe konsulentëve tjerë të angazhuar kemi kuptuar se kualiteti jo i mirë i PZHK-së si dhe zhvillimet që janë bërë jashtë planifikimit të saj kanë ndikuar shumë në përcaktimet dhe kushtet zhvillimore në Hartën Zonale. Kualitetin jo të mirë të PZHK-së, e ka dëshmuar edhe raporti i vlerësimit të kualitetit të PZHK-së të hartuar me ndihmën e GIZ-it, në vitin 2017. Sipas raportit vlerësimi i përgjithshëm i kualitetit të PZHK-së, rezulton të jetë 48,33%, nën mesatare, që i bie se procesi i Hartës Zonale nuk është dashur të vazhdojë tutje me këtë PZHK në fuqi. Ne si drejtori së bashku me udhëheqjen komunale kemi arritur një përfundim se Harta Zonale e Komunës duhet të jetë një dokument i aplikueshëm dhe që ankesat e qytetarëve të merren parasysh, që bizneseve tu krijohet hapësirë për zhvillim, që ndarja në nën blloqe brenda zonës urbane të jetë pa dallim dhe kushte të barabarta, që bujqësisë t'i jepet prioritet në zhvillim e që për të gjitha këto që i përmenda nevojiten disa ndryshime mirëpo dokumenti si tërësi nuk ndryshohet.

Pikat në të cilat duhet të bëhen ndryshime janë: rishikimi i blloqeve dhe etazhiteti në zonën urbane sepse këtu janë dallimet më të mëdha sepse nuk ka barazi në etazhitet dhe në shfrytëzim të projekteve. Të rishikohet dispozita e PZHK-së, në tokën bujqësore ashtu siç është përcaktuar në draft Hartën Zonale të Kosovës, të rishikohet kufiri i tokës ndërtimore në fshatrat për rreth qytetit në të gjitha vendbanimet, të rishikohet koeficienti i ndërtimeve përgjatë rrugës magjistrale Podujevë - Prishtinë, gjithsej në 12 vendbanime, të rritet në P+2 dhe të rritet indeksi i ndërtimit 1,2, si dhe rishikimi i zonës ekonomike dhe zgjerimi i saj. Ne kemi ardhë në përfundim se pika më e rëndësishme është te dispozitat për ndërtesat në fushën e bujqësisë, në draftin e parë të Hartës Zonale që ka marrë pëlqimin nga Ministria përkatëse nuk është përfshirë kjo pikë edhe përkundrazi që në draft Hartën Zonale të Kosovës si dokument kjo pikë është e përfshirë si pikë e veçantë por në dokumentin tonë mungon andaj kemi bërë kërkesë që edhe në draft dokumentin tonë të futet kjo pikë që ne të kemi mundësi t'i trajtojmë kërkesat e qytetarëve për lejimin e ndërtimit të objekteve në fushën e bujqësisë.

Ndërtimi i objekteve në vendbanimet rurale sipas PZHK-së, është vetëm rreth shtëpive e që nënkupton se nëse janë ndërtuar 2 shtëpi kurse për ndërtimin e ndonjë shtëpie të re nuk kemi mundësi t'i japim leje ndërtimi për shkak se kufiri i PZHK-së, është vetëm përreth shtëpive ekzistuese dhe nuk është marrë për bazë gjendja faktike prej vitit 2009, por kjo gjendje është marrë për bazë prej viti 2016, zhvillimi që ka ndodhur jashtë planifikimit në ndërtimet pa leje ka ndryshuar gjendja drastikisht në terren. Të nderuar këshilltar komunal nëse Kuvendi aprovon draft dokumentin e Hartës Zonale të Komunës me një kufi të tillë ndërtimor që është plan i kufirit të planit zhvillimor komunal të përcaktuar në vitin 2009 do të thotë se ne si drejtori duhet t'i refuzojmë investitorët potencial të bizneseve dhe të prodhuesve dhe nuk mund të japim leje ndërtimore për ndërtimin e banesave për një numër të konsiderueshëm të banorëve sidomos në zonat rurale edhe pse ata i kanë parcelat e tyre me kondita të barabarta me ato parcela që janë përfshirë në kuadër të kufirit ndërtimor të PZHK-së. Ne si institucion komunal jemi në kontakt të vazhdueshëm me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe jemi duke pritur përgjigje pozitive për ndryshime në këtë draft dokument.

z.Hasan Ajeti, theksoi, është e vërtetë se Harta Zonale është dokumenti më i rëndësishëm për komunën tonë, për periudhat kohore që kanë të bëjnë me Hartën Zonale ne këtu nuk i takojmë fushës suaj dhe disa shprehje unë nuk i kuptoj por e rëndësishmja e kësaj materie është krahasimi dhe të gjeturat që ju si Ekzekutiv i keni gjetur në raport me dokumentin që ka qenë e i cili realisht i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore. Një gjë është me rëndësi që ka të bëjë me një referim që është bërë nga GIZ-i gjerman, andaj në qoftë se ka mundësi të na sqaroni më praktikisht dhe t'i përjashtoni

terminologjitë profesionale në mënyrë që ta kuptojmë materien dhe të dihen problemet në draftin e Hartës Zonale në qytet edhe në fshatra.

z.Florent Hasani, theksoi, pas gjetjes së mangësive në variantin e draftit të parë të hartuar të Hartës Zonale, të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve ne e dimë që është dashur të ndërhyhet në disa pika me qëllim të rregullimit të Hartës Zonale që përfundimisht të jetë në funksion të interesit të qytetarëve. Mangësitë e paraqitura në draftin e parë të Hartës Zonale mendojmë se patjetër duhet të trajtohen dhe të vazhdojmë me variantin e dytë ku janë të përfshira të gjitha pikat e nevojshme për ndryshim.

znj.Endrita Murati, theksoi, Harta Zonale e Komunës së Podujevës është një nga dokumentet më të rëndësishme për të cilën Kuvendi i Komunës do të vendos. Është instrumenti kyç ndër sektorial që zbërthen më tej vizionin afatgjatë zhvillimor të Komunës duke mundësuar orientimin e investimeve dhe resurseve tjera të Komunës në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Duke qenë e një rëndësie kaq të madhe dhe komplekse, puna në hartimin dhe draftimin e këtij dokumenti do të duhej të mobilizonte jo vetëm Ekzekutivin e Komunës, me theks të veçantë Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrotjtjes së Mjedisit, por edhe Kuvendin e Komunës, komunitetin e profesionistëve të fushave e lëmive multisektoriale, të cilët i përfshinë ky dokument, pastaj komunitetin e biznesit, shoqërinë civile, median, dhe në mënyrë të veçantë qytetarët e Komunës tonë.

Ndikimi i gjithanshëm do të ketë kohështirje shumë më të gjatë se sa vet vlefshmëria e periudhës sa do të jetë Harta Zonale andaj kujdesi, debati profesional i strukturuar dhe i bazuar në parimet të planifikimit strategjik afatgjatë duhet të jetë shterrues, konstruktiv dhe mbi të gjitha gjithëpërfshirës. Nuk ka dyshim se cilësia e këtij dokumenti do të varet nga dy faktor kryesor, do të varet nga ajo se sa Komuna e Podujevës ka të hulumtuara, të studiuara e të dokumentuara potencialet zhvillimore të saj, pastaj nevojat dhe kërkesat për zhvillim ekonomik, social, arsimor, kulturor si dhe do të varet shumë nga fakti se në përplasjet e kërkesave komunitare për hapësirë e shërbime publike në njërën anë dhe kërkesave parciale e private të biznesit në dëm të publikes në anën tjetër, për të cilin vizion do të përcaktohet Komuna e Podujevës. Deri më sot, jemi dëshmitar se si në një ambient pa rend dhe ligj, publikja ka pësuar nga privatja shpesh herë duke shkaktuar dëm të pa kompensueshëm, kështu, kemi humbur shumë nga mundësitë që të kemi hapësirë të mjaftueshme publike por edhe kemi marr një model të zhvillimit ekonomik të pa orientuar që shpesh nuk dihet se ku fillon zhvillimi e ku degradimi i hapësirave tona publike e komunitare. Komuna e Podujevës natyrisht se nuk ka shpëtuar nga kjo e keqe që e ka përfshirë vendin tonë në këto 20 vitet e fundit. Zhvillimi i shturur urban e hapësinor, ku investimet private nga potenciali për zhvillim janë kthyer në burim të degradimit urban, hapësinor, arkitektonik e kulturor, është i pranishëm edhe në Podujevë dhe kjo e frenon në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimin e qëndrueshëm sepse e degradon ambientin, zvogëlon vlerën e pronës, ulë potencialin për të përfituar investime të huaja.

Ndoshta në rastin e Podujevës ekziston një përparësi që në dukje të parë ngjan e çuditshme, për shkak se vite me radhë ka pasur largim të biznesit të madh dhe mungesë interesimi për investime, në këtë trend negativ ekonomik ka përfituar hapësira jonë e cila deri diku është e ruajtur nga zhvillimi i pa planifikuar. Sa do që në krahasim me disa Komuna të afërta Podujeva ka shpëtuar më mirë jo për shkak të kujdesit ndaj hapësirës nga ana e Komunës por për shkak të mungesës së investimeve përsëri, e megjithatë ka zhvillime negative në këtë drejtim. Pra pavarësisht se ky degradim buron nga presioni që privatja t'i mbivendos me çdo kusht publikes, në një pikë vështrim më afatgjatë, përveç se shkatërron vlerën që ka koncepti zhvillimit të qëndrueshëm e harmonik ndërmjet bilancimit të interesit publik dhe iniciativës private, në instancë të fundit, kthehet në dëm edhe të vetë biznesit.

Në vendet e përparuara është në detyrën e autoritetit publik që të merr përsipër të zhvillojë konceptin e planifikimit dhe orientimit të zhvillimit mbi parimin e balancimit të interesave publike dhe private.

Planifikimi i hapësirës duke përcaktuar llojin dhe kategorinë sipas destinimit, shfrytëzimit dhe orientimin e mëparshëm të investimeve publike e private në këto hapësira duke përcaktuar masat e veprimit përkatës përveç kërkesave ligjore të përcaktuara në ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe në Udhëzimin Administrativ nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, është me rëndësi themelore të bazohet në normat teknike të planifikimit urban për qytetin e Podujevës. Dimensioni i rëndësisë së veçantë që do të duhej të konsiderohej gjatë gjithë kohës sa zhvillohet e diskutohet në publik ky dokument, është potenciali i Komunës në zhvillimin ekonomik dhe që nuk duhet të shihet thjeshtë dhe vetëm si kërkesë formale e ligjit dhe udhëzimit administrativ. Nëse bujqësia, turizmi malor, hapësirat komerciale të zhvillimit të biznesit mund të konsiderohen si potenciale të zhvillimit ekonomik lokal ne duam të shohim se si kjo është reflektuar e adresuar në kuadër të Hartës Zonale dhe se si kjo është balancuar me kërkesat për banim, hapësira komerciale apo industriale.

Unë e vlerësoj punën që ka bërë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit deri në këtë fazë dhe disa njësi tjera të Ekzekutivit të Komunës dhe vet Kryetari i Komunës që t'i japin mbështetjen e duhur këtij procesi që të kemi këtë dokument teje të rëndësishëm të aprovuar, por mbi të gjitha të sigurohemi se i njëjti përmban të gjitha standardet dhe kërkesat që i përcakton ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimi Administrativ nr.24/2015.

z.Agim Behluli, theksoi, në parim e përkrahim Hartën Zonale që është një dokument që ka shumë rëndësi, mirëpo unë kam pas disa vërejtje që kanë të bëjnë me afatin prej 8 viteve për ndryshimin e saj sepse brenda 8 viteve mund të ketë shumë ndryshime në të gjithë botën, por edhe qoftë në fushën e urbanizmit apo teknologjisë, andaj 8 vite janë shumë. Do të ishte mirë që sipas mundësive ligjore të zvogëlohet ky afat prej 8 viteve sepse mund të ketë kërkesa nga investitorë të huaj që të investojnë. Miratimi i Hartës Zonale në Komunën e Podujevës është vonuar, i kemi parë të gjithë vendimet e nivelit lokal dhe atyre qendrore, andaj këtë temë nuk po e diskutojmë, më shumë, mirëpo në parim të gjithë ne duhet ta përkrahim miratimin e Hartës Zonale. Kërkesa ime është që procesi i draftimit të Hartës Zonale të jetë sa më transparent dhe të jetë sa më e madhe pjesëmarrja e qytetarëve në debatet publike për hartimin e Hartës Zonale.

Ish drejtorin e kaluar të DPUMM e kam mik, mirëpo drafti aktual i Hartës Zonale të Komunës së Podujevës nuk është hartuar mirë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, unë pajtohem me parafolësit se Harta Zonale është një ndër dokumentet më të rëndësishëm që e ka Komuna e Podujevës, andaj pyetja ime për drejtorin e DPUMM është se cilët janë hapat e ardhshëm që ka me i marrë si Drejtori, për funksionalizimin e Hartës Zonale. Draftimi i Hartës Zonale ka dalë njëherë në dëgjim publik, andaj dua të di se çfarë hapash do të ndërmerri ju që ky dokument të funksionalizohet dhe ku qëndroni në këtë drejtim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, e dëgjova informatën e drejtorit, në parim për trajtimin e lëndëve moralisht e mbështes që si institucion të kemi një përgjigje për t'ju dhënë qytetarëve. Procesi i dëgjimit publik për Hartën Zonale ka kaluar dhe kemi ardhur deri në fazën e miratimit.

Kam disa pyetje konkrete për drejtorin e DPUMM-së, se a janë duke u pajisur me leje ndërtimi ndërtuesit e nivelit të lartë, sidomos në qytet, apo subjektet kërkuese, sa leje ndërtimi janë dhënë nga DPUMM deri në këtë fazë të cilat mund të paraqesin konfrontim deri në Hartën e ardhshme Zonale për arsye se në qytet do të përcaktohen edhe etazhet ashtu siç e ceku drejtori i DPUMM. Duke i përcjellë edhe zonat ashtu siç e ceku edhe drejtori në fjalë, për zonën e Orllanit është duke u bërë një ofensivë e ndërtimeve, nuk e di drejtori a ka qenë më frikë në atë pjesë por janë duke u ndërtuar nga 30 villa duke ndërhyrë në male he kodra të asaj zone dhe a janë të pajisura me leje ndërtimi dhe nëse po në bazë të cilit kriter janë pajisur me leje ndërtimi, për arsye se tani ne mos të biejmë në konfrontim sikurse që ka qenë leja e ndërtimit për kompleksin “Beni Dona” të ish objekti i

“Gërmisë”, ku Plani i Zhvillimor Komunal ka qenë imit urban ka qenë 10 etazhe kurse ndërtuesi i objektit përballë objektit të Komunës e ka ndërtuar objektin në 13 etazhe, tani në bazë të Hartës së re Zonale a do t’i rrënoni ato 3 etazhe në bazë të planifikimit urban apo do ta pajisni me një leje apo çfarë do të bëhet. Harta Zonale nëse sërish duhet të dalë në dëgjim publik pas atij debati që ka qenë, Podujeva do ta ketë sërish të njëjtin avazh, çka më ka interesuar mua më së shumti, sa kam dëgjuar, pasi që drejtori i DPUMM është prezent këtu dhe është në ngjarje sepse subjektet janë duke u pajisur me leje ndërtimi sidomos në qytet, andaj pyetja është se në bazë të cilit kriter janë dhënë lejet e ndërtimit dhe përcaktimi i etazhit a është dhënë në bazë të Planit Zhvillimor Urban që ka qenë deri tani apo në bazë të Hartës Zonale që pritet që në seancën e radhës në Kuvend të miratohet, dhe që tani e tutje do të kemi një pamje të qartë të Podujevës, kurse për zonën e fshatit Orllan, a janë të pajisur të gjithë ata ndërtues me leje, sepse sa kam vërejtur unë në një kodër është bërë zgjerim i rrugës 8-10 m që për këtë zgjerim të rrugës është dashur të merret pëlqim nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, leja Komonale, si dhe miratimin e Ministrisë së Ambientit si dhe lejen nga Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtje të Mjedisit, andaj dua të di nëse janë dhënë këto leje dhe nëse po në bazë të cilave kriteret, nëse nuk janë dhënë këto leje pse nuk ndërhyjnë që të ndalen punimet derisa të bëhet një pamje e qartë se si do të duket Komuna jonë.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket zonës së fshatit Orllan në Hartën Zonale nuk është trajtuar në bazë të kërkesës së Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, çdo ndërtim që zhvillohet apo është duke u zhvilluar në fshatin Orllan, është nën kompetencë të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për këto zona mbrojtëse rreth liqenit.

Ne si Drejtori e kemi lëshuar vetëm një leje që ka qenë në tokë ndërtimore në rreth 400 m², kurse komplet pjesa tjetër e ndërtesave që është duke u zhvilluar është duke u zhvilluar pa leje ndërtimore. Në qytet janë lëshuar lejet e ndërtimit në bazë të Planit Zhvillimor Urban si dhe në bazë të Planit Rregullues-Zona Qendër, që janë në funksion, do të thotë nëse i shikojmë edhe ato leje që janë lëshuar edhe ato i kanë problemet e tyre sepse për një objekt janë marrë si referencë dy dokumente. Për shfrytëzueshmëri të së shkurtës e kanë marrë Planin Zhvillimor Urban që i jep mundësi të zhvillohet deri në 60-70% të ndërtimit që është 8+3, ndërsa për etazhitet e kanë përdor Planin Rregullues-Zona Qendër, të gjitha këto objekte që shihen për rreth e kanë të njëjtin standard dhe kjo nuk ka rrjedhë si mungesë e vetëdijes por e kanë bërë me vetë dëshirë ata, me qëllim që me pas sa më shumë metër katrorë në një objekt. Në momentin që do të miratohet Harta Zonale nuk i atakon ndërtimet që kanë ndodh, ne e kemi një proces të legalizimit që ka ndodhë për ndërtimet deri në vitin 2018, që do të realizohen vetëm në qoftë se janë brenda zonës kadastrale.

Sa i përket pyetjes së z.Agim Behluli për afatin kohor prej 8 viteve, ky është afat 4+4 që mund të bëhet një revidim por arsyetimi për Ministrinë duhet të jetë shumë i qëndrueshëm për dhënien e lejes nga ana e Ministrisë që të bëhet revidimi i Hartës Zonale, kështu që shanset janë minimale që kjo të ndodhë sepse kemi ndërtime me leje dhe pa leje, dhe nga ana e Ministrisë përkatëse merren parasysh të gjitha kriteret.

Për problemet e Hartës Zonale që i ceku këshilltari z.Hasan Ajeti, janë të gjitha këto pika të cilat i cekëm te varianti i parë i draftimit të Hartës Zonale, kurse te varianti i dytë ne i kemi bërë ndryshimet. Ndryshimet janë bërë gjithmonë në bashkëpunim me GIZ-in gjerman. Tani ne kemi një dokument që është i plotësuar me këto ndryshime dhe jemi duke pritur vetëm aprovimin nga ana e Ministrisë, ne nuk do e sjellim draftin e Hartës Zonale në Kuvend pa miratim nga ana e Ministrisë sepse është shkelje ligjore, andaj ne nuk duam të arrijmë deri në atë pikë. Një sqarim po e bëj se në zonën urbane varianti i parë te etazhiteti i objekteve ka dallime të mëdha në kufi të parcelave sepse ka etazhitet P+11, P+7, ka dallime te lagja e spitalit ku një pjesë është P+9, kurse pjesa tjetër është P+7 dhe P+11, kështu që duhet të kemi një uniformitet në trajtim të lartësisë.

Pastaj sipas variantit të parë të Hartës zonale që jemi duke biseduar, kemi zonën të ish “Hotel Besiana” që është P+11, kurse për rreth është P+2, P+3, P+4, kështu që kjo nënkupton se ka pas ndërhyrje direkte nga ana e dikujt.

Te objektet bujqësore kemi pas probleme që nga fillimi sepse prej muajit janar-shkurt bujqit kanë ardhë për me marrë pëlqime për grande, dhe kërkesat e tyre janë trajtuar në bazë të pëlqimit dhe realisht nëse kërkesa është për një pëlqim kjo kërkesë nuk është e parashikuar në bazë të procedurave ligjore si terminologji, andaj ne duhet saktë t’i informojmë bujqit, këtu mundesh ose nuk mundesh të ndërtohet. Duke analizuar projekt Hartën Zonale kemi ardhë në përfundim se pikat e PZHK-së me gjitha dobësitë e saj projekt Harta Zonale ka përvetësuar dhe nuk ka ndryshuar asgjë aty, jo që nuk kanë dashur ndoshta t’i ndryshojnë po ndodhë që edhe Ministria me insistimin e saj nuk ka lejuar të bëhen sepse në filozofinë e tyre është ruajta sa më shumë e tokës bujqësore, por që tani punë e Komunës që interesin e vet ta shtyjë përpara, e them këtë sepse “në qoftë se një zyrtar në Ministri thotë se ju jeni shtet në veti atëherë duhet vetë ne t’i caktojmë ato kriteret”, pastaj dhe të insistojmë që t’i aprovojmë ato ndryshime, pra kjo është pika kryesore që më ka detyruar t’i futem kësaj pune duke qenë në dijeni se me PZHK 48% e ka cilësinë atëherë cilësia e Hartës Zonale nuk mund të dal 50%, por mundet të dal 40% e cilësisë, do të thotë ende më dobët. Komuna e Prishtinës për momentin është duke i aprovuar dy dokumente, PZHK-në dhe Hartën Zonale dhe njëkohësisht është duke i trajtuar të dyja këto dokumente sepse edhe PZHK e Prishtinës ka pas probleme dhe këtu është dashur të veprohet njësoj në një mënyrë, që mos të ketë një Hartë Zonale më të mirë kurse një PZHK jo të mirë.

Pastaj ne kemi edhe pikën që e trajton kufirin ndërtimor ku ne kemi marrë kërkesa për kushtet ndërtimore, sidomos në fshatrat Livadicë, Shtedim, Sekiraçë, Peran, ta zëmë, një familje në qoftë se i ka pasë 2-3 shtëpi kufiri ndërtimor është vën vetëm përreth shtëpive që është i përcaktuar sipas PZHK-së të vitit 2016, kurse sipas projekt Hartës Zonale të Komunës nuk është paraparë zgjerim i familjeve dhe kjo çështje ka mbet në mëshirën e fatit në një formë, e pastaj edhe janë bërë ndërtime pa leje, prandaj kjo është arsyeja që si pikë më ka shtyrë të ec përpara, do të thotë që të parashihen zgjerime të familjeve.

Sa i përket pikës së rrugës magjistrale Podujevë –Prishtinë, në të gjithë Kosovën rrugët magjistrale janë duke funksionuar, do të thotë ka ndërtime dhe po zhvillohen ato pjesë, kurse në Komunën e Podujevës këto ndërtime po zhvillohen pa leje, pa rregulla pa asgjë, këtu ne dëmtohem në aspektin financiar sepse nuk mund t’i realizojmë taksën, prandaj duke parë këto zhvillime e kam parë të arsyeshme që si pikë të futet komplet brezi i rrugës magjistrale Podujevë-Prishtinë nga Merdari deri në kufi me Prishtinën dy brezet e rrugës deri në 100 metër thellësi të lejohet ndërtimi me koeficient 1.2 që i bie përdhese plus dy kate, pra nuk është përcaktuar vetëm si biznes por si pajtueshmëri, që nënkupton edhe ushtrimin e veprimtarisë së biznesit dhe atë të banimit.

Prandaj këto që i ceka janë në mënyrë të detajuar nga unë. Unë edhe më parë e ceka se në qoftë se ky dokument kështu siç është ecë përpara problemet do të jenë të njëjta, presioni nga ana e qytetarëve do të jetë i njëjtë, qytetarët kanë filluar të ndërtojnë dhe ju janë ndalë punimet, e që rrjedhimisht nuk mund të trajtohen sipas variantit të parë të projekt Hartës Zonale, kurse nëse veç ecë procesi me variantin e dytë e që mendoj se duhet të ecë përpara atëherë do të zgjidhen shumë probleme dhe për 8 vitet e ardhshme problemet shkojnë duke u larguar.

Ajo që ka qenë interesante është se me përcaktimin tek Zonës Ekonomike në fshatin Livadicë, kurse zona këndej nga lagja e “Brecalive” ka mbetur zonë agrare ashtu siç ka qenë me PZHK-në e vitit 2016, madje pasi që kam marrë detyrën në DPUMM kam hasur edhe në një peticion të nënshkruar nga banorët e lagjes së “Brecalive” të cilët në fakt edhe i kam kushërinj të cilin nuk e kishte marrë për bazë askush e që mendoj se duhet të trajtohet në një mënyrë duhet trajtuar.

Asgjë të keqe nuk ka në qoftë se e rrisim kufirin ndërtimor të tokës ndërtimore sepse motivohen qytetarët që të jetojnë në qytet, sepse janë më të mira kushtet për jetës si në shkollim dhe edukim të fëmijëve ashtu edhe në atë të kujdesit shëndetësor se sa ata që të jetojnë në zona më të thella të qytetit, ky është trendi andaj në këtë trend nuk mund ta ndalojmë.

Po pres dhe jam duke punuar shumë që të miratohet Harta Zonale, për këtë na duhet ndihma e të gjithëve, pa anime partiake për shkak se ky dokument ka kohëzgjatje 8 vite, kurse jetëgjatësia jonë politike nuk është 8 vite.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për informim apo rikujtimin e juaj, kjo pikë qenë në rend të ditës më parë mirëpo njëra ndër arsyet se nuk ka kaluar është kërkesa e këshilltarit z.Mehmet Gashi si dhe peticioni i banorëve të lagjes së “Brecalive”.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se drejtori bëri sqarime shumë konkrete për këto pika mirëpo pa hy në aspektin politik mendoj se janë të arsyeshme kërkesat dhe trajtimi i zonave urbane në lokalitete që të mos kufizohen në muret e oborreve ose të obligohen të bëjnë ndërtime pa leje sa i përket obligimeve të qytetarëve dhe të atyre institucionale. Sa i përket trajtimit urban Grupi i këshilltarëve të PDK-së i mbështesim këto dy ndryshime duke përfshirë edhe pjesën e aksit të magjistrales Podujevë – Prishtinë që në thellësi 100 m të lejohen ndërtimet P+2, mendoj se është interes familjar i qytetarëve dhe mos t’ju mohohet kjo e drejtë.

Sa i përket ndërtimit në zonën e fshatit Orllan, ku drejtori theksoi se ndërtimet janë duke u bërë pa leje, në këtë rast Drejtoria e Inspeksionit është mirë që ta kryej detyrën e saj, qoftë për pajisjen me leje apo të shikohet se si po bëhen ndërtimet. Rreth enaxhimit të asaj zone e di se brezi uxor i liqenit nën rrugë menaxhohet nga Ministria e Ambientit dhe nga Korporata Energjetike e Kosovës, në gjerësi 30 metra në të dy anët e rrugës dhe në të dy anët e liqenit, mirëpo vendndodhja e ndërtimit të 30 objekteve që kanë filluar të ndërtohen është në pjesën tjetër, nuk them se këto ndërtime paraqesin degradim mirëpo ajo kompani e ndërtimit duhet të pajiset me leje ndërtimore dhe që është lehtësim edhe për kompaninë ndërtimore sepse pajiset me leje të ndërtimit si dhe për Komunën krijohen të hyra vetanake nga tatimi në pronë apo nga leja komunale për arsye se kompania ndërtimore për arsye se nuk mund të punoj askund tjetër si këtu. Ne e dimë se për një zonë të ngjashme si për liqenin e Batllavës ka qenë debati i njëjti për lagjen në liqenin e Badovcit në Komunën e Prishtinës, po thujse këtu është i njëjti biznesmen që ka planifikuar ndërtimin vilave atje, tani ka ardhë këtu pa asgjë hiç (si në bahçe të babës) dhe ka filluar ndërtimet dhe nuk është pajisur me leje ndërtimore. Prezent këtu është drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit dhe Nënkryetarja e Komunës, andaj do të ishte mirë që të dalin në inspektim në terren dhe të shikojnë zhvillimin e ndërtimeve në bazë të parametrave të planifikimit dhe t’ju kërkohet aplikimi për leje të ndërtimit dhe të evidentohen punimet dhe të kryhen tatimet për arsye se krijohen të hyra dhe ata qytetarë pajisen me dokumentacione të rregullta dhe e kryejnë detyrën e tyre.

Një gjë më është dukur jo normale, në mes të ditës, pas 6 muajve qeverisje, me ndodhë gjithë ai ndërtim dhe askush nga ana e zyrtarëve të Komunës të mos e sheh, edhe pse jam i sigurt se këto punime janë vërejtur sepse ditën e diel i kam parë zyrtarët komunal nëse nuk gabohem edhe Kryetarin e kam pa sepse asaj rruge si unë ka kaluar. Ai biznesmen nuk i ka kryer obligimet përveç nëse është takuar me Kryetarin, por nëse nuk është takuar me Kryetarin, duhet në institucion të merret leja ndërtimore. Sërish po e them se nuk jam për ndërprerje të punës, kushdo qoftë ai por duhet të vij në institucion dhe të pajiset me dokument dhe t’i tregoj dikujt se çfarë po ndërton aty, sepse ai është duke bërë ndërtime në interes tonin, për çdo ndërtim e zhvillim që bëhet.

Vetë zyrtarët e Komunës deklarohen se ato ndërtime janë duke u bërë pa leje dhe nuk ndërmerren veprime, do të thotë se kjo çështje nuk është në rregull, pse po e them këtë sepse janë dy ose tri kërkesa që janë paraqitur për marrje të lejes ndërtimore dhe nuk ju është dhënë leja, po flas për të

kaluarën jo tani, pra me arsyetimin se duhet ruajtur ambienti, uji, koeficienti i ndërtimit, etazha, materiali ndërtimor të jetë nga druri etj, kështu që këtu ka diskriminim lidhur me objektet ndërtimore. Me planin e ri nëse diku i lejohet ndërtimi deri në 10 kate e dikush e ka bërë më herët ndërtimin në 13 kate, është shkelje e drejtave të njeriut dhe shkelje e ligjit. Sa i përket dy pikave sidomos të etazhitetit dhe kërkesës se atyre 10 lokaliteteve që t'ju jepet e drejta për ta shfrytëzuar pronën e tyre për të ndërtuar objektet e tyre sipas parametrave që Komuna i parasheh, qofshin ato ndërtime edhe në një fshat të thellë që mos t'ju mbetet barrë se ku do të ndërtojnë shtëpitë e banimit, ato familje që kanë shumë anëtarë dhe nuk kanë mundësi ta dinë se ku mund ta ndërtojnë një shtëpi. Kërkoj nga ana e juaj që sa më shpejt që të jetë e mundur t'i mbani kontaktet që të dalë dokumenti për miratim, po flasë personalisht, mirëpo besoj se asnjëri nga ne këtu nga cilido subjekt politik nuk do ta refuzojnë funksionalizimin e hartës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, i nderuari drejtor sipas informacioneve që na i dhe ju keni bërë shkresë në Ministrinë përkatëse për t'i vijuar rekomandimet, kur do të jetë i gatshëm ky dokument për shkak të nevojës që e trajtuam të gjithë.

z.Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit - DPUMM, ndër të tjera theksoi, afatin ligjor nuk e di sepse në mënyrë specifike dhe konkrete nga ana e Ministrisë nuk na kanë jep ndonjë rekomandim konkret për periudhën kohore se a do të jetë një apo dy javë. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm prej javës së kaluar e këtë kontakt edhe këtë javë do ta vazhdojmë dhe shpresojmë se deri në fund të javës do ta marrim një aprovim të ndryshimeve sepse ndryshimet nuk e prekin dokumentin në tërësi. Korniza e dokumentit mbetet e njëjta, për këtë arsye ne kemi kërkuar aprovimin që mos të ketë përsëri debat publik dhe mos të humbim më shumë kohë, mirëpo nëse prapë kërkohet që drafti i Hartës Zonale të dalë në dëgjim publik ky draft do të del në dëgjim publik për arsye se më mirë është t'i humbin një ose dy muaj kohe se sa 8 vite. Një dokument jo i hartuar mirë të jetë në funksion për 8 vite, me të vërtetë është shumë keq, me një dokument që është i përpiluar si ai më parë i jep mundësi drejtorit dhe zyrtarëve të DPUMM që të bëjnë lloj lloj lojërash në kurriz të bizneseve, për ta hequr këtë drejtë është mirë që t'i kalojmë këto ndryshime. E rëndësishme është se etazhitetin nga Harta Zonale kam propozuar që të hiqet për shkak se është një pikë që tekstualisht në dokument është mbi shtresore, ata që kanë njohuri në këtë fushë në bazë të këtij dokumenti e dinë që ka mundësi që të ketë metra katrorë më shumë, kjo ka mbetur për dy ose tre persona që të kenë qasje në këtë pikë. Etazhiteti largohet dhe në vend të tij vihet koeficienti i ndërtimeve, në Komunën e Prishtinës është testuar se koeficienti është më i përshtatshëm sepse dihet totali i m², shfrytëzueshmëria e shportës, etazhiteti s'është i përcaktuar, kriteret dihen se sa duhet larguar prej kufirit përcjellës, atëherë nëse shtrihet aq sa është e mundshme ndërtimi mund të bëhet P+2, P+5, P+7, nuk është i përcaktuar kriteri i etazhitetit por është i përcaktuar koeficienti i ndërtimit, kalkulimi me grafitor është më stabil dhe gjithçka është në rregull, kështu mendoj unë. Sa i përket zonës së fshatit Orllan është një vendim i Qeverisë i vitit 2013 për zonën mbrojtëse të liqenit të Batllavës, ku ndahen 2 kategori, kategoria e parë 10 metra, kategoria e dytë 100 metra që nuk lejohet kurrfarë ndërtimi. Këto ndërtime që po zhvillohen afër restorant Adriatiku shumica prej tyre janë në një largësi prej 200 metrave, andaj këta ndërtues s'kanë arsye të kërkojnë leje ndërtimore se njëfarë mënyre ne nuk mund t'i trajtojmë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ndërtimet që janë duke u bërë te vendi i quajtur "Bërryli i Xhakalivë" i kalojnë të gjitha parametrat, ne po e kuptojmë situatën.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM, ndër të tjera theksoi, sa i përket menaxhimit të kësaj zone, së pari të gjitha veprimet e mbikëqyrjes duhet t'i ndërmarrë Ministria përkatëse, sepse është nën kompetencën e saj, nëse Ministria nuk mundet t'i ndërmerr të gjitha veprimet atëherë i drejtohet

Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Podujevës, kjo është rregull që e kam të konfirmuar përmes e-mailit, sepse kam kërkuar vendim nga ana e tyre për këtë pikë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, faleminderit për informacionet i nderuari drejtor, po e mbylлим debatin rreth kësaj pike sepse ballafaqimi nuk është i lehtë. Unë sërish e them se për ndërtimin e objekteve të Bërryli i Xhakalivë duhet të shikohet se a kanë marra leje ndërtimi ata ndërtues. Në muajin gusht Kuvendi është në pushim vjetor dhe nuk e di se a do të mbahet ndonjë seancë apo mund të thirret ndonjë seancë e jashtëzakonshme, mirëpo në muajin korrik mund të caktohet mbajtja e një seance të Kuvendit, andaj ju duhet të prisni që në bazë të njoftimeve të nxirrni vendimet që edhe një herë në tërësi drafti i Hartës Zonale mos të kalojë në procedurën e dëgjimit publik. Deri në seancën e radhës të Kuvendit që do të mbahet në muajin korrik organet qendrore nuk të japin përgjigje për vendimet që drafti i Hartës Zonale t'i nënshtrohet procedurës së dëgjimit publik me këto ndryshime që në muajin shtator të kemi mundësi që të miratohet Harta Zonale brenda periudhës që ju e parashihni. Në fillim të muajit shtator mendoj që ka hapësirë 1 muaj për dëgjimin publik që t'i kalojmë barrierat sepse ne na takon ta kryejmë punën tonë andaj një muaj le të presim pastaj në muajin korrik të thirret seanca e Kuvendit me rend dite dhe të miratohet dokumentoi me këto ndryshime.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është mirë që po vërehet një disponim i të gjitha grupeve të subjekteve politike përmes këshilltarëve të tyre që të punohet dhe të përkrahet kjo pikë e rendit të ditës në mënyrë që Komuna jonë ta ketë një dokument funksional që është njëri nga dokumentet më të rëndësishme.

z.Bedri Maçastena, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, theksoi, sa i përket ndërtimit në fshatin Orllan ju njoftoj se ai persona ka leje të ndërtimit dhe rruga për të cilën po flitet ka qenë rrugë e vjetër dhe paraqitur edhe në hartë por është bërë zgjerimi i saj. Herën e dytë kur kemi inspektuar ne kemi vërejtur se pak është tejkaluar paksa planin e lejes ndërtimore dhe i kemi ndërprerë punimet dhe tani ai persona është duke u përgatitur për të marrë lejen e ndërtimit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës

7. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-020/04-0035824/21 i datës 29 prill 2021, i ndërlidhur Me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018 për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc

- Shkresa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës nr.02-1804-2/21 e datës 08.06.2021, e përcjellë përmes Ministrisë së Pushteti Lokal - Shkresa nr.020-396/10 të datës 10.06.2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht keni vërejtur nga materialet se për një vendim të Kuvendit të Komunës që është marrë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës përmes Ministrisë së Pushtetit Lokal ka kthyer një shkresë sipas të cilës vendimi në fjalë është karakterizuar së i kundërligjshëm, kështu që ne si Kuvend ashtu siç parashihet me dispozita ligjore duhet ta ri shqyrtojmë në afat prej 30 ditëve në mënyrë që të marrim hapin e duhur ligjor, konkretisht mendim i imi është që vendimi në fjalë duhet të shfuqizohet, andaj rreth kësaj çështje e hap debatin.

z.Hasan Ajeti, theksoi, këtu kemi të bëjmë me ri shqyrtimin e një dokumenti, referuar materialit kjo është një shkresë e Ministrisë përkatëse lidhur me vendimin që është marrë në Kuvend, mirëpo arsyetimi mendoj se është pak i mangët. Ministria përkatëse kur e ka dhënë këtë vlerësim po e citoj: *hyrja e vendimit nuk i referuar dispozitave e Ligjit nr.03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.22/20210 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit*, kjo shkresë nuk është e definuar qartë andaj do të ishte mirë që edhe një herë të ketë komunikim mes zyrës së Kryesuesit dhe Ministrisë respektive që përmbajtja e materies për të cilën po flitet të jetë pastër, përkundrazi gjykoj se këtu mund të ketë konflikt kompetencash mes Ekzekutivit dhe Legjislativit të Komunës. Në kuadër të funksioneve ju që mbani do të ishte mirë që sërish të kërkonti edhe një sqarim me të detajuar sepse është shumë lehtë me nxjerrë vendim por duhet të shikohet se ai vendim a prodhon efekt apo pasoja në të ardhmen.

z.Ragip Fetahu, theksoi, edhe pse në këtë komision për të cilin po flitet figuron emri im nuk e di a kam të drejtë ta shpreh mendimin tim rreth kësaj çështje, mirëpo ky vendim i Ministrisë përkatëse është vendim jo i mirë për shkak se shkakton telashe ligjore për të gjitha vendimet që i ka marrë ky komision dhe në bazë të këtij vendimi i bie që ky komision të shpërbëhet nga Kuvendi, të shfuqizohet vendimi i Kuvendit dhe të gjitha kompetencat për formimin e komisionit të ri t'i kalojnë Kryetarit. Mendoj se të gjitha vendimet që janë marrë në të kaluarën nga ky komision në bazë të këtij vendimi i bie që janë anti ligjore dhe në bazë të rrugëve ligjore mund të hidhen poshtë nga secila palë. Zyra ligjore duhet ta bëjë një interpretim para se Kuvendi ta marrë një vendim tjetër.

z.Fatmir Rudari, theksoi, si anëtarë i komisioni deri në momentin e fundit e kemi kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Sipas dispozitave të ligjit të ri sa kuptova unë këto kompetenca i kalojnë Kryetarit, ndërsa ligji nuk vepron në mënyrë retroaktive, ato janë për të kaluarën, kurse tani këto kompetenca kalojnë te Kryetari i Komunës. Sa kuptova unë ky komision duhet të shpërndahet dhe Kryetari duhet ta caktoj një komision dhe vetëm emrat t'i propozon në Kuvend.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, ndër të tjera theksoi, sipas referencës që ka dhënë Ministria përkatëse nënkupton se këto kompetenca i takojnë Kryetarit të Komunës, që ta formoj komisionin në koordinim me Kryesuesin e Komunës.

z.Agim Behluli, theksoi, unë kam qenë kryetar i këtij komisioni, vlen të ceket se para këtij komisioni ka qenë i formuar një komision tjetër, në qoftë se ky komision ka qenë jo legjitim atëherë edhe komisioni i mëparshëm ka qenë jo legjitim që i ka shpërnda 50 shtëpi, kurse në këtë përbërjen e komisionit që kam qenë unë janë shpërnda 56 shtëpi, do të thotë se po kthehemi në vitin 2014.

Ju lutem që të merreni seriozisht me këtë temë sepse tingëllon keq në opinion por edhe te përfituesit e shtëpive në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, vendimi është kthyer dhe ne nuk mund ta revokojmë, përgjigja është e formës së prerë, Ligji i ri e parasheh përbërjen e Komisionit ashtu siç e ka kthyer përgjigjen Ministria përkatëse. Kuvendi në të kaluarën ka vepruar në bazë të Memorandumit dhe Marrëveshjes me Ministrinë e së Mirëqenies Sociale me Kryetarin e Komunës, mirëpo zyra ligjore e ka këtë Memorandum besoj dhe në bazë të atij Memorandumi është lejuar dhe krijuar komisionet prej Kuvendit. Tani për formimin e komisionit, nga Kryetari duhet të bëhen propozimet e reja, duhet të shfuqizohet rregullorja aktuale që e rregullon këtë çështje, është i ngritur komisioni i cili është dashur të plotësohet dhe ndryshohet. Tani mendoj se ne duhet t'i marrim dy veprime, ta shfuqizojmë Rregulloren e nxjerrë sipas Memorandumit si dhe të shpërndahet komisioni aktual si dhe të jepen propozimet e reja nga Kryetari i Komunës, kështu është e rregulluar kjo çështje sipas procedurës administrative. Mendoj se në këtë përbërje të komisionit Kryetari mund t'i propozoj të njëjtit anëtar apo anëtarë tjerë nga Ekzekutivi. Kjo është çështje tjetër për ndarjen e këtyre dy apo tri shtëpive të fundit që kanë mbetur në atë Lagje. Komisioni aktual që ka qenë i përbërë nga anëtarë të të gjitha

subjekteve politike punën e tij e ka kryer shumë mirë dhe nuk ka pas ankese, shtëpitë do t'ju ndahen atyre familjeve që kanë vendim, por si do që të jetë cila është kërkesa e Ekzekutivit tani për Kuvendin, a keni kërkesë ju zotëri Kryesues apo ju zonja Nënkryetare që të lirohet nga detyra komisioni aktual dhe të shfuqizohet Rregullorja përkatëse apo vetëm po debatohet rreth kësaj çështje për të cilën përgjigjen e ka dhënë Ministria, ka thënë se vendimi është i pa ligjshëm.

Tani ju duhet të na udhëzoni se si të veprojmë sepse nëse dëshironi me shpërbë komisionin ajo është çështje e juaja, zyra ligjore e komunës nuk ka përgjigje për këtë sepse zyra ligjore e nivelit qendror nxjerrë aktvendim në bazë të legjislacionit në fuqi, e legjislacioni në fuqi është ai të cilit iu ka referuar Ministria përkatëse, ku Kryetarëve të Komunave u jepet ajo e drejtë për formimin e komisioneve në fjalë. Ky komision ka qenë në vazhdimësi i rregulluar më herët në bazë të Memorandumit dhe akteve tjera pasuese, tani dy komisione nuk mund të jenë në fuqi, prandaj të shpërndahet ky komision apo nëse ka unanimitet të propozohen të njëjtat anëtar nga ana e Kryetarit dhe të miratohet ky komision në Kuvend në mënyrë që ta përfundojnë detyrën e tyre ku ka mbet, kjo çështje mbetet në disponimin e Kryetarit të Komunës. Kuvendi nuk mund të propozoj anëtar të komisionit sepse në të kaluarën ne kemi propozuar anëtarin për zëvendësim të këtij komisioni mirëpo vendimi është kthyer dhe ne tani presim se si do të veprojmë tutje Ekzekutivi i Komunës lidhur me këtë çështje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo pikë ka ardhë në rendin e ditës pas përgjigjes së Ministrisë përkatëse andaj unë e kam vënë në rend të ditës për arsye të respektimit të afatit ligjor prej 30 ditëve për zbatimin e ligjshmërisë. Ekzekutivin e kam informuar lidhur me çështjen në fjalë dhe jemi dakorduar për këtë, prandaj sot jemi këtu në këtë seancë pas përgjigjes së Ministrisë përkatëse që vendimi për formimin e këtij komisioni duhet të shfuqizohet, ndërsa për procedurat e më vonshme sigurisht Kryetari do t'i propozoj emrat e anëtarëve të atij komisioni, pra kalojnë kompetencat nga Kuvendi te Kryetari i Komunës.

z.Haki Rudari, theksoi, duke qenë pjesë e këtij komisioni për 4 vite ndjehem i obliguar që ta marrë fjalën, mirëpo në të njëjtën kohë kam dy dokumente, atë të datës 10 prill 2014 ku Kuvendi i Komunës së Podujevës ka marrë vendim për ngritjen e komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, në nenin 1 të këtij vendimi parashihet përbërja e këtij komisioni ku tri subjektet politike përfaqësohen me nga një përfaqësues, një përfaqësues nga shoqatat e dala nga lufta, dhe një përfaqësues nga Ekzekutivi. Ky vendim i Komunës ka kaluar në Ministrinë përkatëse sipas nenit 6, dhe në nenin 11 thuhet pas vlerësimit nga ana e Ministrisë. Pastaj e kam këtu një Rregullore e cila është miratuar më datë 27.12.2014, në bazë të të cilës Kuvendi i Komunës së Podujevës miraton një rregullore për caktimin e kriterëve për dhënie të shtëpive në shfrytëzim në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc. Në këto dy raste vendimi i Komunës për formimin e komisionit dhe Rregullorja e Kuvendit të Komunës për caktimin e kriterëve kanë qenë në rregull sa i përket aspektit ligjor, andaj këto dokumente nuk e di se a i janë nënshtruar shqyrtimit të ligjshmërisë ku Ministria përkatëse ka kthyer përgjigjen si të ligjshme.

Tani nëse ka ndryshuar ligji unë nuk mund të japë përgjigje, por duhet zbatuar ligji.

z.Ragip Fetahu, theksoi, do të ishte mirë që ta marrim një mendim nga ana e zyrës ligjore lidhur me këtë çështje para se të shfuqizohet vendimi në fjalë, nëse kemi ndonjë mendim konkret nga zyra ligjore ne do ta shfuqizojmë këtë vendim, kam frikë se do të kemi problem me ligjin dhe me palët në të ardhmen nëse shfuqizohet ky vendim. Propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës deri sa të merret një mendim nga zyra ligjore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se në bazë të sugjerimeve të Ministrisë përkatëse që kompetencat për formimin e këtij komisioni i takojnë Kryetarit të Komunës, jemi të detyruar t'i japim zgjidhje kësaj çështje, andaj

këtë pikë të rendit të ditës e vë në votim sipas rekomandimit dhe udhëzimit të Ministrisë përkatëse të përcjella përmes Ministrisë përkatëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se (nga 24 anëtarë të Kuvendit sa ishin momentalisht prezent në sallë) 14 vota janë PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e PËRMBAJTUR, pra me shumicë të anëtarëve që janë të pranishëm dhe që votuan, shfuqizohet Vendimi nr.prot.01-020/04-0035824/21 i datës 29 prill 2021, i ndërlidhur Me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018 për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc.

7. Të ndryshme

z.Hasan Ajeti, theksoi, në emër të Grupit të Këshilltarëve të LDK-së kam një kërkesë lidhur me fjalorin e drejtorit të DBF z.Fatlum Osmani, ndaj të gjithë neve këtu e në veçanti ndaj Grupit të këshilltarëve të LDK-së. I kuptoj përplasjet dhe konceptet ideologjike dhe politike por është e pa pranueshme dhe asnjëherë më parë nuk është praktikuar në këtë Kuvend një gjuhë e tillë e cila e cenon integritetin personal për atë fjalë që përdori për atë djalin me simptomë. Shprehjet apo cilësimet si të “pa kulturë” nuk të bëjnë aspak njeri me edukatë apo të kulturuar, normalisht do të ishte kulturë dhe etikë kërkim falja për atë fjalë që e ka thënë.

Nëse Drejtori nuk kërkon falje për shprehjet dhe ofendimet e bëra, ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së do ta bojkotojmë secilën paraqitje të tij në këtë Kuvend. Është jo etike që të përgjithësosh të gjithë njerëzit sepse në fund të fundit ne kemi opinione të ndryshme mirëpo ne nuk jemi armiq por duhet të bisedojmë në bazë të argumenteve, aq më pak një djalë që vjen nga një familje që prindi i tij ka qenë arsimtar. Është i tmerrshëm fjalori i djalit të një pedagogu se si vepron në Kuvend.

Pyetja e radhës është për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, sepse në seancën e kaluar ka qenë në vizitë zyrtare në Republikën e Turqisë, andaj nga ana e tij i kërkojmë disa sqarime, çfarë ka ndodhur me tenderin për serrat 50m², tenderi për mëshqerra që ka qenë tender me kushte të veçanta referuar dosjes së tenderit që e kam parë, dhe më datë 24.05.2021 është nënshkruar kontrata për furnizim ku kanë qenë specifikat e kontratës të cilat ju duhet t’i dini, andaj na tregoni se deri ku është implementuar ai projekt.

z.Fatmir Rudari, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit –DKA, ditëve të fundit një pjesë e mësimdhënësve që kanë arrit moshën e pensionimit nuk po mund t’i gëzojnë tri paga bazë që ju takojnë pas arritjes së moshës së pensionimit. Kam pas disa kërkesa nga ana e tyre andaj edhe e parashtoj këtë pyetje, nëse ka mundësi të na jepni sqarime lidhur me këtë çështje sepse para disa muajve këtë të drejtë e kanë realizuar, kurse këta muajt e fundit jo.

z.Kasib Bashota, theksoi, kam tri kërkesa të qytetarëve drejtuar Ekzekutivit, kërkesa e parë ka të bëjë me lagjen përballë qendrës tregtare “Agnesa”, ku ajo lagje gjatë stinës së vjeshtës dhe stinës së dimrit është e rrezikuara nga vërshimet, kërkoj nga drejtori i DSHPMSh, Kryetari i Komunës dhe Nënkrjetarja e Komunës që këtyre banorëve t’ju bëhet një zgjidhje afat gjatë sepse këta banorë me të vërtetë janë në gjendje të vështirë. Banorët e kësaj lagjeje e meritojnë të kenë një zgjidhje të problemit të tyre andaj ne të gjithë së bashku duhet të punojmë edhe si Kuvend nëse është nevoja që të ndajmë mjete buxhetore për zgjidhjen e problemit në fjalë.

Banorët e lagjes ‘Kodralliu’ në fshatin Llapashticë, kërkojnë nga Komuna që t’ju bëhet një zgjidhje lidhur me rrugën që ka të bëjë me pronat e tyre sepse kjo rrugë është e pa qasshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, për drejtorin e DBPZHR e kam një kërkesë për seancën e radhës së Kuvendit që ta përgatit një raport për gjendjen në bujqësi.

Për Ekzekutivin kam një kërkesë pasi që prezent është Nënkryetarja e Komunës, kërkesë zyrtar e cila është bërë dy gupet që ishim në opozitë në qeverisjen e kaluar, tani njëra prej tyre është në pozitë, kërkesa ka qenë që të lidhet një kontratë me TV Llapi, për përcjelljen e seancave plenare.

Sa kam njohuri të gjitha Grupet e këshilltarëve e kanë këtë kërkesë, ju them të drejtën unë kam menduar se Kuvendi i Komunës ka lidhë kontratën me TV Llapi, sepse ekipa e TV Llapi rregullisht po i përcjellin mbledhjet e Kuvendit por sa vërejta kjo po bëhet vetëm ashtu nga vullneti i lirë i tyre, andaj dua të ndërlihem me deklarimin e Kryetarit të Komunës në një seancë të kaluar të Kuvendit i cili e tha se kur të propozoni diçka duhet të na tregoni edhe nga ti marrim mjetet buxhetore, dhe në këtë aspekt po ju tregoj destinimin e mjeteve për këtë kontratë Në bazë të njoftimit të bërë Kryetari atë ditë në debat zyrtarisht na njoftoi se ka dështuar tenderi për serra sepse janë larguar operatorët, si dhe për anulimin e tenderit për pemët dekorative që është anuluar tenderi që ishte në vlerë rreth 70,000.00€. Sigurimi bankar kalon në pronësi të Komunës për shkak të dështimit të operatorëve ekonomik, këto mjete mbesin si mjete financiare shtesë të cilat Komuna nuk i ka pasë. Kërkoj që nga kjo shumë e cila nuk e dëmton aspak buxhetin komunal që janë mjete shtesë, dhe që me keq ardhje e them se këta tenderë nuk është dashur të dështojnë, andaj këto mjete janë të mjaftueshme, nuk e di se sa është oferta e TV Llapi për përcjelljen e seancave të Kuvendit, por konsideroj se ky Kuvend duhet të nënshkruaj kontratë me TV Llapi për përcjelljen e 12 seancave plenare në vit për arsye se televizionet tjera në nivel vendi nuk kanë shprehur interesim për këtë çështje.

Ne kemi vetëm një televizion lokal dhe do të ishte mirë që t'i krijojmë mundësi që zyrtarisht t'i përcjellë seancat plenare të Kuvendit të Komunës.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, sa i përket transmetimit të seancave të Kuvendit nga TV Llapi, ju njoftoj se TV Llapi ka paraqit kërkesë zyrtare në zyrën e Kryetarit të Komunës, për transmetimin e këtyre seancave dhe këtë kërkesë e ka përcjellë në Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financave, kjo kërkesë është në procedurën e prokurimit dhe shumë shpejt pritet të finalizohet Marrëveshja.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, sa i përket kërkesës së banorëve të lagjes afër qendrës tregtare “Agnesa”, mund të them se në atë lagje ka shumë problem me ujërat atmosferike, ne kemi dërguar kërkesa në Ministrinë përkatëse për ndërtimin e një kolektori për të bërë zgjidhjen e atij problemi. Me këto mjete buxhetore që kemi ne si Komunë nuk mund të bëjmë ndërtimin e atij kolektori.

Ne i kemi njoftuar banorët në rast se Ministria përkatëse nuk na mbështet për zgjidhjen e atij problemi, ne ato tubacione do t'i pastrojmë dhe do të bëjmë një zgjidhje.

Sa i përket rrugës së lagjes “Kodralliu” kërkesën e kemi, procedurat kanë filluar dhe është çështje kohe deri në fillimin e punimeve.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, sa i përket pagave përcjellëse deri në muajin mars nuk kemi pas probleme, gjatë muajit mars është shfaqur ky problem. Komuna e Podujevës i ka të planifikuara mjetet, mirëpo problemi qëndron te Ministria e Financave, konkretisht drejtpërsëdrejti kur kemi biseduar me zyrtarët e Ministrisë përkatëse na kanë thënë se për shkak të rastit të 2,100,000.00€ që ka ndodhë në Ministri të Financave, ka shkaktuar dëme financiare në Republikën e Kosovës dhe duhet pritur deri në rishikimin e buxhetit që do të bëhet në muajin qershor komfor afatit ligjor.

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, z.Hasan Ajeti ju parashtruat dy pyetje rreth realizimit të projektit për serra dhe projektit për mëshqerra. Sa i përket projektit të serrave që është iniciuar në bazë të afateve kohore të rregullta, gjithçka ka shkuar në bazë të procedurës së prokurimit, është realizuar kontrata mirëpo kur ka arritur procedura e finalizimit të kontratës operatori ekonomik ka ngec për arsye të ngritjes së çmimeve në treg. Ne kemi marrë vendim për shkëputje të kontratës dhe procedurave tjera, konfiskimin për 10% si dhe futjen e operatorit ekonomik në listën e zezë.

Projekti i mëshqerrave është realizuar në bazë të aktit ashtu siç ka qenë, në qoftë se keni ndonjë pyetje specifike unë do t'ju përgjigjem sepse projekti është realizuar dhe gjithçka ka qenë në rregull dhe për realizimin e këtij projekti mund t'i pyesni fermerët dhe do t'ju njoftojnë ata edhe më mirë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, për me i pyet fermerët je ti (i drejtohet drejtorit parafolës) sepse ju duhet t'i pyesni ata e jo të përgjigjeni, megjithatë kjo është temë tjetër. Unë parashtrova pyetje dhe nuk e di a e keni shikuar kontratën që është kontratë me kushte të veçanta. Kjo kontratë nëse nuk gabohem është lidhur më datë 24.05.2021, pesë ditë pasi të nënshkruhet kontrata janë kushtet e veçanta që bëhen dërgesat. Mëshqerrat a kanë ardhë dhe prej cilit vend të BE-së, lista e përfituesve e nënshkruar në kontratë nuk është publikuar. Pas sa ditëve që është nënshkruar kontrata është publikuar lista e përfituesve të fermerëve, a ka mundësi të na tregoni pasi që e hapët këtë temë, po pres përgjigje.

z.Vigan Salihu, drejtor i DBPZHR, theksoi, zotëri Ajeti, lista e përfituesve të fermerëve nuk publikohet pa u lidhë kontrata, kështu ju keni vepruar me projektin për motokultivator dhe na keni sjellë në një situatë të tillë. Lista e përfituesve nuk publikohet pa u lidhë kontrata dhe pa u siguruar operatori ekonomik. Në kontratë janë specifikat, oferta, prodhimi, mostra dhe të gjitha çështjet tjera. Për ato zëra që kam dëgjuar për çmimet e larta, këto çmime varen prej vendit se nga vijnë këto mëshqerra e që në këtë rast vijnë nga Republika e Çekisë, dhe gjithçka është cekur në atë parametër, andaj edhe gjithçka është në rregull, është realizuar kontrata në mënyrë shumë të suksesshme.

z.Hasan Ajeti, theksoi, mos na lexoni keq kur bëjmë pyetje sepse e keni obligim t'ju përgjigjeni pyetjeve tona si Kuvend. Sa i përket motokultivatorëve e kam thënë por nuk keni qenë prezent në seancë, ju nuk jeni personi që i anuloni vendimet e organit që i ka nxjerrë ato vendime, këtë ju duhet ta kuptoni mirëpo unë ju amnistoi sepse ju jeni inxhinier i bujqësisë dhe nuk jeni jurist. Sa i përket ankesës ne e dimë se çka është OSHP-ja dhe çka shqyrton dhe trajton OSHP-ja, për këto veprimet e juaja, në qoftë se keni pas kompetencë apo autorizim nga Kryetari z.Shpejtim Bulliqi atëherë ajo është temë tjetër, e për këtë temë ju duhet të uleni te z.Fatmir Gashi atje ku është vendi i Kryetarit dhe Nënkyetarit/es. Për këtë pikën që ka të bëjë me kontratën për mëshqerrat ke këtë fushë. Kontratën e ke të nënshkruar më datë 24.05.2021, listën e përfituesve e ke shpallur pas 5 dite dhe ju e keni nënshkruar atë kontratë. Dosjen e kam shtyp dhe e kam lexuar, pas 5 ditëve e keni dërgesën sipas specifikave kaq kisha.

z.Vigan Salihu, drejtor i DBPZHR, theksoi, kontrata për mëshqerrat ka qenë shumë e suksesshme. Sa i përket motokultivatorëve as unë e as Kryetari nuk kemi bërë anulim, por kemi bërë njoftim sipas OSHP-së, që ka japë verdiktin dhe atë e kemi respektuar. Nuk kemi të bëjmë asgjë me këtë çështjen e motokultivatorëve, shikojeni mirë se si shkruan lista, njoftim i anulimit, jo anulim, unë dhe Kryetari nuk e kemi anuluar atë projekt, vetëm kemi zbatuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ju kuptoj drejtor në përgjigjet e juaja ngase se këto tema janë të rënda por ju kanë dështuar tenderët për bletë, për serra që keni bërë premtime, pastaj keni munguar në seancën e fundit ku në emër tuajin ka fol drejtori i DBF-së që ka deklaruar se tenderi për drunjët dekorativ ka filluar të dështoj. Matjen e drunjëve dekorativ a e keni bërë në shesh, në çfarë madhësie janë ata

drunjë, a i keni parë gjendje se si është në shesh për këta 8 muaj që jeni në pushtet sepse kjo çështje nuk është veç sot, prandaj këto nuk janë jashtë kompetencës së fushës të cilën ju e drejtoni.

Këta drunjë dekorativ nëse janë sipas specifikave atëherë bie në kundërshtim kolegu juaj me atë që ka deklaruar, të gjithë ne që dalim në shesh e shohim gjendjen aktuale, këtu nuk mund ta amnistosh askënd.

z.Ragip Fetahu, theksoi, mendoj se prapë në këtë pikë po shkelet Rregullorja e punës së Kuvendit sepse në pikën Të Ndryshme, kemi të drejtë vetëm të ngrisim çështje dhe të parashtrojmë pyetje konkrete, e jo të bëjmë replika, kundër replika dhe argumente, kundër argumente, tha ai ose i thashë. Është shumë me rëndësi që të respektohet Rregullorja e punës, për këtë çështje mund të iniciohet një seancë dhe të diskutojmë për problemet në përgjithësi në fushën e bujqësisë, por jo në këtë pikë.

z.Vigan Salihu, drejtor i DBPZHR, theksoi, këtu janë dy projekte, ai i sheshit dhe ky projekt për të cilin ju thoni se ka dështuar, ky projekt ka dështuar sepse ka qenë projekt i mbikëqyrur dhe nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara sipas kontratës, për këtë arsye ka dështuar ky projekt dhe do të dështojë gjitha ato projekte të cilat nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara.

Më herët pse nuk ka pas mbikëqyrje dhe janë realizuar projekte të dështuara, kjo është çështje tjetër, një ndër këto projekte është ai i bletarisë që ka dështuar .

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 15:15

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0051828/21

Podujevë,

28 qershor 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi